Shoqeria Koncesionare “Albrail” Sh.p.k

# DEKLARATA
# E RRJETIT HEKURUDHOR
# TË ADMINISTRUAR NGA SHOQËRIA
# KONCESIONARE “ALBRAIL” SH.P.K

# 2026




**E vlefshme duke filluar nga 10.12.2025**

**Fier, 10 Gusht 2025**

# TË DHËNA RREGULLATORE:

**HARTUAR NGA:**

Ing. Gramoz Aliaj, Pergjegjes i Infrastruktures FIRMA: ________________
Ing. Vionis Laçi, Pergjegjes i Mjedisit dhe Sigurise FIRMA: ________________

DATA: 01 Gusht 2025

**RISHIKUAR NGA:**

Nderim Kasa, Drejtor Teknik FIRMA: ________________

DATA: 08 Gusht 2025

**MIRATUAR NGA:**

Dritan Spahiu, Administrator FIRMA: ________________

DATA: 10 Gusht 2025

Nr: 1 (nje)

KOPJE: 3 (tre)

Nr. i FAQEVE: 41 (pa anekset)

Nr. i SHTOJCAVE: 3

LËSHUAR NGA : Shoqëria koncesionare “Albrail” Sh.p.k.

## TABELA E NDRYSHIMEVE

| Numri i ndryshimeve | LËNDA | Publikuar në publikimin zyrtar | | I vlefshme nga |
|---|---|---|---|---|
| | | Numri | Viti | |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
| 1 | Deklarata e Rrjetit Hekurudhor të Albrail shpk | 1 | 10.08.2025 | 10.12.2025 |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

1 Informacioni i përgjithshëm ........ 9
1.1 Hyrje........ 9
1.2 Objektivat e Deklarates se Rrjetit........ 9
1.3 Struktura ligjore per pergatitjen e Deklarates se Rrjetit........ 9
1.4 Gjendja Ligjore e Deklarates se Rrjetit ........ 9
1.4.1 Përcaktimi i përgjithshëm........ 9
1.4.2 Informacion mbi ndryshimet e planifikuara ose modernizmin e IHA për periudhën tjetër të orareve. 9
1.4.3 Shpjegime në lidhje me Deklaratën e Rrjetit dhe sigurimi i informacionit shtesë. ........ 10
1.5 Struktura e Deklarates se Rrjetit ........ 10
1.5.1 Lidhjet me Deklaratën e Rrjetit të vendeve te tjera........ 10
1.6 Vlefshmeria dhe perditesimi i Deklarates se rrjetit........ 10
1.6.1 Vlefshmëria e Deklarates së Rrjetit........ 10
1.6.2 Perditesimi i Deklaratës së Rrjetit........ 10
1.7 Publikimi, shperndarja dhe mundesia e hyrjes ne Deklaraten e rrjetit ........ 11
1.8 Informacioni i kontaktit ........ 11
1.8.1 ........ 11
1.9 Bashkepunim midis Administruesve te tjere te infrastruktures ........ 12
Rail Net Europe (RNE) – bashkëpunimi ndërkombëtar midis menaxherëve të infrastrukturës. ........ 12
1.9.1 Shërbime me nje sportel të vetëm ( One Stop Shops) – OSS për klientët ........ 12
1.10 Pershkrimi i termave dhe shkurtimeve ........ 13
1.10.1 Termat e perdorur ne Deklaraten e Rrjetit kane kuptime si me poshte:........ 13
1.10.2 Shkurtimet e përdorura në këtë Deklaratë Rrjeti kanë kuptimet e mëposhtme: ........ 15
2 Kushtet për përdorim të infrastrukturës hekurudhore ........ 16
2.1 Struktura ligjore ........ 16
2.2 Kushtet per shperndarjen e itinerarit te trenave........ 16
2.2.1 Kushtet e përgjithshme për shpërndarjen e itinerarit të trenave për lloje te vecantë. ........ 16
2.2.2 Aplikantët........ 16
2.2.3 Licensa ( Leje Veprimtarie )........ 17
2.2.4 Certifikatat e Sigurisë........ 17
2.3 Si te aplikosh per nje itinerar trenash........ 18
2.4 Kushtet e pergjithshme te biznesit mbi perdorimin e infrastruktures hekurudhore. ........ 18
2.4.1 Marrëveshja kuader........ 18
2.4.2 Kontratë Perdorimi (Shfrytëzimi)........ 19
2.4.3 Shërbime ne objekte e impiante te tjera........ 19
2.5 Perdorimi i rregulloreve te trafikut ........ 19
2.6 Transport i jashtezakonshem ........ 19

**2.7 Transporti i mallrave te rrezikshme ....20**

**2.8 Pershtatshmeria e mjeteve levizese te transportueseve hekurudhore....20**

**2.9 Stafi i kualifikuar i Transportuesit hekurudhor....21**

**2.10 Menaxhimi i IHA ....21**

**3.1 Percaktimi i infrastruktures Hekurudhore ....21**

**3.2 Hapesira e shtrirjes se IH....21**

3.2.1 Përcaktimi gjeografik i IHA.... 21
3.2.2 Rrjetet hekurudhore te vëndeve fqinje .... 22

**3.3 Pershkrimi i IH....22**

3.3.1 Karakteristikat Teknike të IH.... 22
3.3.1.1 Llojet e vijave .... 23
3.3.1.2 Hapesira midis shinave.... 23
3.3.1.3 Stacionet dhe nyjet.... 23
3.3.2 Limitet e IHA .... 23
3.3.2.1 Profili i Hapesires se Lire.... 23
3.3.2.2 Ngarkesat e lejueshme per aks dhe per meter linear.... 25
3.3.2.3 Menaxhimi i pjerrësive dhe rezistenca e lëvizjes në vijat e IH .... 25
3.3.2.4 Shpejtësia per vije.... 25
3.3.2.5 Gjatësia maksimale e vijave ne stacione: .... 25
3.3.2.6 Kodifikimi i vijave per transport te kombinuar.... 25
3.3.3 Kontrolli teknik i trafikut dhe sistemet e komunikimit .... 26
3.3.3.1 Pajisjet e sinjalistikës dhe te sigurisë .... 26
3.3.3.2 Kontrolli teknik i menaxhimit te trafikut.... 27
3.3.3.3 Sistemet Telekomunikacionit.... 27
3.3.3.4. Lidhjet nepermjet njoftimeve me radio .... 27

**3.4 Kufizimet ne transport ....27**

3.4.1 Bllokime te infrastrukturës.... 27
3.4.3 Transporti i mallrave te rrezikshme.... 28
3.4.4 Kufizime ne tunele .... 29
3.4.5 Kufizimet ne ura.... 29
3.4.6 Kufizime të tjera.... 29

**3.5 Rezervime ne Infrastrukture....29**

**3.6 Stacionet e Udhetareve ....29**

**3.7 Terminali i mallrave ....29**

3.7.1 Stacionet, të përcaktuar vetëm për formimin e trenave ( marshalling yards ) : .... 30
3.7.2 Stacionet, ku ngarkimi dhe shkarkimi i mjeteve personale është i mundur:.... 30
3.7.3 Stacion, i hapur per levizje rruge-hekurudhe.... 30
3.7.4 Stacione me terminal kontenieri .... 30

**3.8 Aktiviteti i Sherbimit ....30**

3.8.1 Peshoret hekurudhore : .... 30
Peshoret ndodhen ne stacionet e ngarkimit te naftes bruto Drize dhe ne PIA Vlore (peshoret ne PIA Vlore menaxhohen nga vete PIA).... 30
3.8.2 Stacioni i ngarkimit te naftes bruto ne qytetin e Fierit ne Drize. .... 30
3.8.3 Pajisje të pastrimit të akullit:.... 33
3.8.4 Parku i Lokomotivave:.... 33
3.8.5 Mirëmbajtja teknike.... 34
3.8.6 Stacionet e furnizimit me karburant:.... 34

**3.9 Zhvillimet e infrastruktures** ........ **34**

**4 Shperndarja e itinerareve të trenave** ........ **34**

**4.1 Kuadri ligjor** ........ **34**

**4.2 Pershkrimi i Procedures** ........ **34**

**4.3 Afati kohor per kerkesat dhe alokimin e itinerarit te trenit** ........ **35**
4.3.1 Kërkesat ne oraret e rregullta për itinerarin e trenit ........ 35
4.3.2 Kërkesa e rastit (Ad hoc) për itinerare treni në një afat të shkurtër kohor ........ 35

**4.4 Formulari aplikimit per alokimin e itinerarit te trenit** ........ **36**
4.4.1 Organi kompetent ........ 36
4.4.1.1 Aplikimi i plotësuar ........ 36
4.4.1.2 Konfidencialiteti i informacionit ........ 36
4.4.1.3 Përcaktimi i grupeve të itinerarëve ndërkombëtar të trenit ........ 36
4.4.1.4 Drafti i orarit të rrjetit ........ 37
4.4.1.5 Zëvendësimi i itinerarëve të trenave ........ 37
4.4.1.6 Proçedura e Konsultimit ........ 37
4.4.1.7 Ndryshimet në kërkesat për alokimin e itinerarëve të trenave ........ 37
4.4.2 Proçedura e bashkerendimit, faktorët shtesë ........ 37
4.4.3 Infrastruktura me kapacitet të mbingarkuar ose tejngopur. ........ 38
4.4.4.1 Njohja e urdhrave me shkrim mbi alokimin e itinerarëve ndërkombëtar të lëshuar nga menaxherë të huaj infrastrukture ........ 39
4.4.5 Pagimi i kostove të proçedurës në rast të mos alokimit të itinerarit të trenit ........ 39
4.4.7 Zgjidhja e ankimimit lidhur me alokimin e itinerarit të trenit ........ 40
4.4.8 Proçedura e Ankimimeve ........ 40

**4.5 Alokimi i itinerarit të trenit për mirëmbajtje të ih** ........ **40**

**4.6 Mos shfrytëzimi i itinerarëve të trenave** ........ **41**

**5 Shërbimet** ........ **36**

**5.1 Kuadri ligjor** ........ **36**

**5.2 Shërbimet bazë** ........ **36**

**5.3 Shërbime te tjera** ........ **36**

**5.4 Shërbime shtese** ........ **37**

**5.5 Shërbimet ndihmese** ........ **37**

**6 Tarifat** ........ **38**

**6.1 Baza ligjore** ........ **38**

**6.2 Metodologjia e perllogaritjes se tarifave te perdorueseve te trete te hekurudhes** ........ **38**
6.2.1 Shërbimet që përbëjnë tarifën ........ 38
6.2.2 Parimet e tarifimit ........ 38
6.2.3 Formula e llogaritjes së tarifave të perdorimit ........ 38
6.2.4 Vlerat e elementëve të veçantë të formulës për llogaritjen e tarifës perdorimit ........ 38
6.2.4.1 Koefiçienti i rendesise vijes hekurudhore P : ........ 38

6.2.4.2 Koefiçientët e amortizimit të shinave – K ..... 39
6.2.4.3 Faktori për kërkesën e Transportuesit Hekurudhore ne lidhje me orarin – F ..... 39

**1 ..... 39**

**6.3 Çmimet ..... 39**
6.3.1 Çmimi për tren kilometër ..... 39
6.3.2 Çmimi i shërbimeve shtesë ..... 39
6.3.3 Çmimi i shërbimeve të tjera ..... 39
6.3.4 Shpenzime të jashtme ..... 39

**6.4 Parimet baze te tarifimit ..... 39**

**6.5 Perjashtime nga tarifa e perdorimit ..... 40**

**6.6 Ndryshimet e tarifave ..... 40**

**6.7 Revokimi dhe anullimi i itinerarit të trenave ..... 40**

**6.8 Zbritje te tarifes ..... 40**

**6.9 Ndryshimi i itinerarit te trenit ..... 41**

**7. Shtojcat ..... 41**

## HYRJE

Shoqëria koncesonare “Albrail” sh.p.k (ne vijim e quajtur: Albrail) dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, më datë 04 Shkurt 2016 kanë lidhur Kontratën e “Koncensionit/Partneriteti Publik Privat të formës (ROT) për Rehabilitimin, Operimin dhe Transferimin e Infrastrukturës Hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë”.

Në 2018 Albrail përfundoi rehabilitimin e linjës hekurudhore Fier-Vlorë dhe të degëzimeve hekurudhore të rafinerisë Fier dhe te PIA (Petrolifera Italo-Albanese).
Në 26 Dhjetor 2018 Albrail pajiset nga Qendra Kombetare e Biznesit me licencen e “Veprimtarise në transportin hekurudhor në rrjetin hekurudhor shqiptar (transport hekurudhor i udhëtarëve dhe bagazheve), nderkohe eshte pajisur nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës edhe me licencën e Administruesit të Infrastrukturës Hekurudhore per linjen hekurudhore Fier-Vlore dhe Fier-Ballsh.
Në dhjetor 2018 Albrail fillon operimin në linjën hekurudhore Fier-Vlorë dhe specifikisht në transportin e naftës bruto.

Në cilesinë e administruesit te infrastrukturës hekurudhore, bazuar në Kodin Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë Nr.142/2016 si dhe Kontratën Koncesionare të nënshkruar me Shtetin Shqiptar, Albrail ka detyrimin që t’i japë akses transportuesve të tjerë hekurudhor në zonën qe ka nën administrim, kundrejt pagesës se tarifes sipas ligjeve ne fuqi.

Bazuar sa më sipër, Infrastruktura Hekurudhore nën administrimin e Albrail (në vazhdim e quajtur: IHA) duhet të përgatisë dhe publikojë deklaratën e rrjetit hekurudhor që ka nën administrim.

Përgatitja e Deklaratës së rrjetit është bërë në përputhje me Kodin Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë, Nr 142/2016, akteve nënligjore të rrjedhura prej tij, në perputhje me Kontratën e “Koncensionit/Partneriteti Publik Privat të formës (ROT) për Rehabilitimin, Operimin dhe Transferimin e Infrastrukturës Hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë” si dhe rekomandimeve të Bashkimit Europian.

Deklarata e rrjetit përmban informacione mbi IHA, kushtet e përdorimit te infrastrukturës, proceduren për shpërndarjen e itinerareve të trenave, shërbimet e vlefshme për përdoruesit e IHA dhe mbi metodologjine e perllogaritjes së tarifës së përdorimit.

Pjesa përbërëse e Deklaratës së Rrjetit do te jetë informacioni mbi shërbimet e ofruara nga IHA dhe operatoret e impianteve ndihmese. Gjithashtu pjesë përbërese e Deklaratës së rrjetit janë edhe Shtojcat 1, 2 dhe 3.

# 1 INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM

## 1.1 HYRJE

Deklarata e Rrjetit të IHA përmban informacion për këdo subjekt që është i gatshëm të ofrojë shërbime transporti në këte rrjet hekurudhor.
Deklarata e Rrjetit përgatitet dhe publikohet për cdo orar në veçanti. Administruesi i IHA është organi kompetent për pergatitjen dhe publikimin e Deklaratës së Rrjetit.
Informacioni i publikuar ne këtë Deklaratë të Rrjetit do te jetë i vlefshëm për oraret e trenave te periudhës 2025/2026 duke filluar nga 10.12.2025 deri me 09.12.2026.

## 1.2 OBJEKTIVAT E DEKLARATES SË RRJETIT.

Objektivat kryesore për t'u arritur nga Deklarata e Rrjetit janë si më poshtë:

- T'u ofrojë aplikuesve informacionin e nevojshëm për pjesëmarrje në procedurën e shpërndarjes së itinerareve të trenave,
- Të përcaktojë afatet që aplikanti duhet të ndeshë dhe marrë parasysh në procedurën e shperndarjes se itinerareve te trenave,
- Të japë informacionin kryesor mbi infrastrukturën hekurudhore dhe shërbimet,
- Te informoje aplikuesit mbi afatet e perdorimit te infrastruktures hekurudhore.

## 1.3 STRUKTURA LIGJORE PËR PËRGATITJEN E DEKLARATËS SË RRJETIT.

Deklarata e Rrjetit përgatitet në përputhje me:

- Kodin Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë nr 142/2016 i cili ka hyre ne fuqi me 12.01.2018 dhe akteve n/ligjore ne zbatim te tij.
- Kontratën e “Koncensionit/Partneriteti Publik Privat të formës (ROT) për Rehabilitimin, Operimin dhe Transferimin e Infrastrukturës Hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë”
- Tarifen e perdorimit infrastruktures hekurudhore.

## 1.4 GJËNDJA LIGJORE E DEKLARATËS SË RRJETIT

### 1.4.1 Përcaktimi i përgjithshëm

Deklarata e Rrjetit është një dokument pa ndonjë vlerë kontraktuale. Kushtet e Përgjithshme të Biznesit mbi përdorimin e infrastruktures hekurudhore, do të percaktohen me lidhjen e kontratës së nënshkruar për perdorimin e rrjetit midis Administruesit të IHA dhe aplikuesit.
Informacioni i publikuar në Deklaratën e Rrjetit nuk ka ndikim në legjislacionin kombëtar.
Deklarata e Rrjetit është publikuar në dy gjuhë, në Anglisht dhe Shqip. Në rast paqartesie, do të përdoret versioni Shqip.
Administruesi i Infrastruktures nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë informacion te pasaktë në Deklaratën e Rrjetit në lidhje me infrastrukturën dhe shërbimet jashtë kompetencës së tij.

### 1.4.2 Informacion mbi ndryshimet e planifikuara ose modernizmin e IHA për periudhën tjetër të orareve.

Informacioni në Deklaratën e Rrjetit për ndryshimet e planifikuara të IHA dhe/ose afatet e përdorimit mund të përdoren për secilën periudhë oraresh si një njoftim dhe një ndihmë në procedurën e shpërndarjes së itinerareve të trenave, por Administruesi i IHA nuk do t'i marrë parasysh ato si marrëveshje të detyrueshme për të kryer ndryshimet.

### 1.4.3 Shpjegime në lidhje me Deklaratën e Rrjetit dhe sigurimi i informacionit shtesë.

Aplikuesit mund të kerkojnë për ndonjë shpjegim ose informacion shtesë për Deklaratën e Rrjetit nga Administruesi i IHA ( kontaktet janë shpallur ne paragrafin 1.8 ) në formë të shkruar, ose me e-mail. Kerkesat për shpjegim ose informacion shtesë duhet të paraqiten te Administruesi i IHA jo më vonë se 20 ditë para fillimit të aplikimit për shpërndarjen e itinerareve të trenave. Administruesi i IHA do t’i përgjigjet vetëm kërkesave të paraqitura para afatit të fundit dhe do t’i dërgoje aplikuesit një shpjegim të shkruar jo më vonë se 10 ditë nga marrja e kërkesës.

## 1.5 STRUKTURA E DEKLARATËS SË RRJETIT

Deklarata e Rrjetit në strukturën e vet ndjek pozicionin e zakonshem në lidhje me strukturën e Deklaratës së Rrjetit, te përshtatur brenda Rrjetit Hekurudhor Europian (RNE) dhe është ndarë në 6 kapituj bazë, si më poshtë:

- Informacion i pergjithshëm ,
- Kushtet e shfrytëzimit të IHA,
- Infrastruktura hekurudhore,
- Shpërndarja e itinerareve të trenave ,
- Shërbimet,
- Tarifat e përdorimit

### 1.5.1 Lidhjet me Deklaratën e Rrjetit të vendeve te tjera

Deklaratat e Rrjetit të vendeve të tjera të cilët janë anëtare te Organizatës së Menaxherëve të Infrastrukturës Hekurudhore Europiane gjenden në www.railneteurope.com.

## 1.6 VLEFSHMËRIA DHE AZHORNIMI I DEKLARATËS SË RRJETIT

### 1.6.1 Vlefshmëria e Deklarates së Rrjetit

Informacioni i Deklarates së Rrjetit është përdorur për pergatitjen e tabelës se orareve të trenave per periudhën 2025/2026.

Deklarata e Rrjetit për periudhen tjetër të tabelës së orareve mundet të publikohet jo më vonë se kater muaj para perfundimit të afatit per kerkesat për kapacitete infrastrukturore.

### 1.6.2 Perditesimi i Deklaratës së Rrjetit

Deklarata e Rrjetit mbahet e përditesuar dhe ndryshohet sipas nevojës. Administruesi i IHA do të paraqesë perditesimet në website e tij si një Shtojcë në Deklaratën e Rrjetit me një numër korrespondues.

Përditësimet mund të referohen drejt:

- Perditesimeve të vogla në përmbajtje,
- Perditesimeve në lidhje me infrastrukturën e cila nuk mund të parashikohet në kohën e publikimit,
- Perditesimeve për shkak të rregullimeve të legjislacionit, ose të një legjislacioni të ri.

Aplikuesit janë të detyruar të njihen me azhornimet e këtij dokumenti.

## 1.7 PUBLIKIMI, SHPËRNDARJA DHE MUNDËSIA E HYRJES NË DEKLARATËN E RRJETIT

Deklarata e Rrjetit mund ti kërkohet e shkruar ose me e-mail Administruesit te IHA me një kosto prej 50 € , për printim dhe shpërndarje ne Republikën e Shqiperise. Deklarata e Rrjetit është e publikuar dhe e lirë për t'u shkarkuar në gjuhët Shqip, Anglisht dhe Italisht në website të Administruesit të Infrastrukturës (www.albrail.al).

## 1.8 INFORMACIONI I KONTAKTIT

Për cdo informacion shtesë për afatet dhe informacione të tjera të përfshira në Deklaraten e Rrjetit, ose për porosinë e Deklaratës së Rrjetit të printuar, si edhe të tjera cështje, aplikuesit mund të kontaktojnë:

**Njesia e Administrimit te Infrastruktures Hekurudhore Fier-Vlore**
Tirane
“Lagje nr 2, Rruga Faik Konica,
Pallati AL & GI, Hyrja 1, Kati 4, Tirane”.
**Kontaktet :**
Tirane
“Lagje nr 2, Rruga Faik Konica,
Pallati AL & GI, Hyrja 1, Kati 4, Tirane”.
info@albrail.al

### 1.8.1

► **Deklarata e Rrjetit:**
Shoqeria koncensionare “Albrail” SH.P.K
**Njesia e Administrimit te Infrastruktures Hekurudhore Fier-Vlore**
Fier
Tel.: + 0697084802
e-mail: info@albrail.al

► **Koordinator OSS ne IHA :**
► ***Shoqeria koncensionare “Albrail” sh.p.k***
Njesia e Administrimit te Infrastruktures Hekurudhore Fier-Vlore

► **Lejet e vecanta të transportit**
**Shoqeria Koncensionare “Albail”** SH.P.K.
Njesia e Administrimit te Infrastruktures Hekurudhore Fier-Vlore

► **Licenca dhe certifikata e sigurise (Rregulloret):**
Ministria Infrastruktures dhe Energjise

► **Aplikimi dhe shpërndarja e itinerareve të trenave:**
Shoqeria koncensionare “Albrail” sh.p.k.
Njesia e Administrimit te Infrastruktures Hekurudhore Fier-Vlore
Aplikimet e pranuara: **Cdo dite pervec te dieles.**

## 1.9 BASHKËPUNIM MIDIS ADMINISTRUESVE TË TJERË TË INFRASTRUKTURËS

**Rail Net Europe (RNE) – bashkëpunimi ndërkombëtar midis menaxherëve të infrastrukturës.**

Për te trajtuar biznesin e Infrastruktures së Hekurudhes Europiane, Menaxheret e Infrastruktures se Hekurudhes Europiane krijuan një organizim të perbashket ne Janar 2004.

RailNetEurope perfaqeson anetaret e vet si një Shoqeri për Lehtesimin e Trafikut Nderkombetar ne Infrastrukturen Hekurudhore Europiane nepermjet nje zyre te perbashket per koordinim me Zyren Qendrore ne Viene.

RailNetEurope ështe nje hap i vijueshëm nga bashkëpunimi bilateral drejt atij multilateral midis menaxherëve të Infrastrukturës Hekurudhore Europiane drejt një organizmi të përbashket me nje qellim Trans-Europian. Anetaret e RailNetEurope rane bashkarisht dakort mbi afatet dhe te zbatojne perpjekje te perbashketa per te permiresuar biznesin e Infrastruktures Hekurudhore Europiane dhe perfitimin e nje industrie te tere hekurudhore.

RailNetEurope përbehet nga disa menaxhere infrastrukture , te cilet janë per me teper anëtare me të drejta te plota ose kandidate. Partneret e RailNetEurope mbulojnë një rrjet prej përafersisht 23.000 km te infrastrukturës hekurudhore.
Menaxheret e infrastrukturës te perfshirë ne RailNetEurope kujdesen për 120 kliente të cilët tregtojne me biznese ndërkombetare në Europe, dhe qellimi kryesor i grupit eshtë RailNetEuropa. Për me teper, jane me shume se 300 nderrmarrje te tjera hekurudhore që tregtojne vetem me trafikun hekurudhor kombëtar.

Për informacion shtese vizitoni: www.railneteurope.com

Infrastruktura e shoqerise koncensionare “Albrail” nuk eshte ende anetare e RAIL NET EUROPE dhe nuk mund te kryej transport nderkombetar por pranon te gjitha procedurat per transport nderkombetar.

### 1.9.1 Shërbime me nje sportel të vetëm ( One Stop Shops) – OSS për klientët

Menaxheret e Infrastruktures Hekurudhore Europiane kanë nenshkruar një marrëveshje mbi organizimin e nje tregu të perbashkët dhe marketingu per kapacitetin e infrastruktures nderkombetare e quajtur RailNetEurope ( RNE ). Menaxheret e infrastruktures kane themeluar One Stop Shop per te vepruar si nje pike kontakti rrjeti per klientet brenda RNE. Klienti do te paraqese kerkesen për itinerar trenash ndërkombetar drejt njeres nga pikat e kontaktit, dhe me vone do te fillojë procesi i shperndarjes ndërkombetare të kapacitetit të infrastrukturës.

Pika e kontaktit në bashkëpunim të ngushtë me menaxherin e infrastrukturës do të:

- Ofrojë informacionin e klientit në lidhje me gamën e gjithë të produkteve dhe shërbimeve të menaxhereve të infrastrukturës;
- Sigurimin i informacionit të nevojshëm për të përdorur infrastrukturën e cdo menaxheri të përfshire RNE;
- Kërkesat e operimit për ndonjë itinerar trenash ndërkombëtar brenda RNE;
- Sigurimi i komunikimit në kohë të kërkesave në lidhje me periudhen e ardhshme të orareve në procesin e planifikimit vjetor të orareve të trenave;
- Pregatitja e ofertave të itinerareve të trenave për linjën ndërkombetare në tërësi.

Cdo pikë kontakti është pjesë e rrjetit ndërkombetar që ofron përdorim me të lehte të rrjetit nga klientët. Pika e kontaktit siguron gjithashtu informacion në tarifat e infrastrukturës dhe lëvizjen e trenave, duke përfshire monitorim cilësor. Sipas motos së tij “nje person per te gjitha sherbimet ndaj klientit (one face to the customer)”, pavarësisht kufijve midis shteteve, pikat e kontaktit ofrojnë ndihmë profesionale dhe eficente bazuar ne veprime transparente, konfidenciale dhe jo-diskriminuese.

Nje listë pikash kontakti eshtë e disponueshme në : www.railneteurope.com.

## 1.10 PERSHKRIMI I TERMAVE DHE SHKURTIMEVE

### 1.10.1 Termat e perdorur ne Deklaraten e Rrjetit kane kuptime si me poshte:

| | |
|---|---|
| **Shpërndarje** | Do te thote caktimi i itinerarit te trenave te shperndare drejt operatorit te transportit; |
| **Perdorim i infrastruktures hekurudhore** | Eshte perdorim i infrastruktures hekurudhore shteterore ne territorin e Republikes se Shqiperise |
| **Kliente te tjere të interesuar** | Jane klientet biznesi i te cileve ose jeta jane te ndikuar nga sherbimet e operatorit te transportit (unione lokale, kompani) |
| **Kapaciteti i Infrastrukturës** | Eshte informacioni mbi ngarkesen e itinerareve te trenave ne lidhje me treguesit e tij teknike dhe te sigurise, i cili eshte lejuar ne nje seksion ose pjese te IH ne nje periudhe kohe te caktuar; |
| **Infrastruktura me kapacitet të kufizuar** | Do të thotë një seksion ose pjesë e IH , ku në harmonizimin midis kërkesave të ndërrmarrjeve hekurudhore, nuk është e mundur të permbushen terësisht kërkesat për itineraret e trenave ose kapacitetin e infrastruktures.; |
| **Transport i jashtëzakonshëm** | Eshtë transporti me mjete hekurudhore bosh ose plot të cilat e kalojne masën e ngarkesës, ngarkese maksimale, kodet e përshkruara për vijat hekurudhore dhe ngarkesën për boshtëm, të përcaktuara nga ligji dhe rregulloret e lëshuara te bazuara |
| **Infrastruktura Hekurudhore Koncensionare** | Eshte infrastruktura hekurudhore koncensionare e zoteruar nga shoqeria koncensionare “Albrail” SH.P.K |
| **Transporti Publik i Pasagjerëve** | Eshtë transporti i pasagjereve i lejuar per këdo nën te njëjtat kushte dhe të ofruar nga operatori i transportit bazuar në kontratën e përfunduar të transportit. |
| **Shoqata Ndërkombetare e Biznesit** | Eshtë nje shoqatë me të paktën dy operatore transporti bazuar në shtete te ndryshme, anëtare të Bashkimit Europian, objektivi i te cilëve eshtë të kryejë shërbime transporti hekurudhor ndërkombetar midis shteteve anetarëve të Bashkimit Europian. |
| **Itinerari i Trenave** | Eshte itinerari i trenit me nisje dhe mberritje ne stacionet hekurudhore ne IH. |
| **Plani i zgjerimit të kapacitetit** | Eshte nje mase ose set masash te kryera nga menaxheri per rritjen e kapaciteteve, ose te propozuara drejt autoriteteve kompetente per te eleminuar pengesat, duke shkaktuar nje infrastrukture me kapacitet te limituar. |

| | |
|---|---|
| **Marrëveshja Kuader** | Eshte nje marreveshje e zakonshme e cila vendos nevojat e kapacitetit te operatoreve te transportit ne nje periudhe afatgjate sesa ne nje periudhe te vetem oraresh; |
| **Rrjeti** | Eshte teresia e rrjetit hekurudhor e operuar nga administruesi; |
| **Tarifa Baze** | Eshte tarifa per sherbimet minimale te kryera nga administruesi i IHA. |
| **Shërbimet e transportit** | Eshte transporti i pasagjereve ose mallrave ne transportin hekurudhor kombetar dhe nderkombetar |
| **Ndërmarrje Hekurudhore** | Eshte nje kompani aktiviteti kryesor i saj eshte ofrimi ose sigurimi i sherbimeve te transportit hekurudhor e cila zoteron nje license per sherbime te ofruara dhe siguron tërheqjen e trenit, ose nje kompani qe kryen tërheqjen e trenit duke zoteruar nje license; |
| **Deklarata e Rrjetit :** | Eshte nje dokument me informacion mbi rregulla procedura dhe kritere lidhur me tarifat e perdorimit te infrastruktures hekurudhore, si dhe mbi kapacitetet dhe skemat e ndarjes se kapaciteteve te infrastruktures; |
| **Infrastruktura Speciale** | Eshte nje seksion ose pjese e IH e projektuar ne menyre specifike per tipe te vecante transporti dhe eshte percaktuar nga administruesi ne Deklaraten e Rrjetit; |
| **Procesi i zgjidhjes së pakënaqësive brenda struktures së procedurës së shpërndarjes së itinerarit të trenave** | Është procedura e zgjidhjes së pakënaqësive mbi shpërndarjen e itinerareve të trenave dhe tarifat e perdorimit të infrastrukturës hekurudhore shteterore, ku me ndihmën e nje pale të pavarur, ata përpiqen të arrijnë një marrëveshje brenda strukturës së procedurës së shpërndarjes së itinerarit të trenave. |
| **Njësite Ligjore** | Jane organizma ligjore me nje status te nje njesie ligjore sipas legjislacionit te vendit ku jane regjistruar. |
| **Shërbimet hekurudhore të transportit** | Eshte transporti i pasagjereve dhe/ose mallrave ne transportin hekurudhor kombetar dhe nderkombetar |
| **Përpjekje e IH** | Eshte e drejta e perdorimit te infrastruktures se hekurudhes koncensionare nen kushtet e paracaktuara. |
| **Aplikues** | Eshte nje nderrmarrje ose nje grupim nderkombetare i sipermaresve hekurudhor ose ndonje njesi tjeter ligjore, e cila, ne saje te interesave publike ose tregtare ka nevoje per itinerar trenash; |
| **Rail Net Europe ( RNE )** | Eshte shoqata europiane e menaxhereve te infrastruktures, e themeluar per te perkrahur trafikun hekurudhor ne kufij. |
| **Autoriteti Rregullator** | Eshte nje Autoritet i cili eshte pergjegjes per zbatimin e parimeve baze te Kodit Hekurudhor te Republikes Shqiperise dhe eshte kompetent per stabilizimin e pakenaqesive kundrejt veprimeve ne lidhje me shperndarjen e itinerarit te trenave, duke monitoruar tarifat dhe leshimin e licensave si dhe qellimeve te tjera te percaktuar nga Kodi Hekurudhor; |

| | |
|---|---|
| **Sistemi i itinerarit të trenave** | Eshte sasia e itinerarit te trenave ne dizpozicion ne rrjetin e orareve per shperndarjen nderrmarrjeve hekurudhore. |
| **Tranziti** | Eshte e drejta per te perdorur infrastrukturen hekurudhore nderkufitare permes se ciles nderrmarrja hekurudhore perdor infrastrukturen per nje udhetim me tren nga nje kufi kombetar drejt nje tjetri pa ngarkim/shkarkim te mallrave, pa hipje zbritje te udhetareve ne Republiken e Shqiperise; |
| **Përdoruesi** | Eshte aplikanti me nje itinerar te shperndare ne IH; |
| **Administruesi infrastruktures** | IHA eshte nje njesi ligjore pergjegjese per mirembajtjen e infrastruktures hekurudhore koncesionare dhe menaxhimit te trafikut hekurudhor. |
| **Bashkërendimi** | Eshte procedura ku administruesi i infrastruktures dhe nderrmarrja hekurudhore perpiqen te zgjidhin cdo situate qe rrjedh nga plotesimi i kerkesave e paleve te interesuara per kapacitete infrastrukturore. |
| **Vlefshmëria e Orareve** | Eshte periudha e kohes ne fuqi e orareve te trenave |
| **Itinerari i Trenave** | Eshte kapaciteti i infrastruktures se transportit i nevojshem per levizjen e trenave midis dy vendeve ne nje periudhe te caktuar kohe. |
| **Kërkesat Kontradiktore** | Jane kerkesat e dy ose me shume aplikuesve per te njejtin itinerar ose itinerare te ndryshme qe koincidojne ne te njejtin seksion ose pjese te IH. |
| **Kërkesat e Rastit (ad hoc)** | Eshte kerkesa per itinerar, e cila eshte e pamundur per tu kerkuar ne nje procedure normale te pregatitjes se planit te orareve, meqenese nuk eshte marre vesh me heret per te. |
| **Periudha e orareve** | Eshte periudha e vlefshmerise se orareve duke filluar te djelen e javes se dyte te Dhjetorit te vitit fillestar dhe duke mbaruar te Shtunen e dyte ne Dhjetorin e ardhshem. |
| **Rrjeti i orareve** | Është nje dokument i IHA duke perfshire të dhëna mbi lëvizjet e planifikuara të trenave dhe mjeteve hekurudhore në kohën e vlefshmërise së tyre; |
| **Oraret** | Është një plan teknologjik i ndërmarrjes hekurudhore për nje periudhë të përcaktuar oraresh, të kryer ne baze te rrjetit te orareve. |

### 1.10.2 Shkurtimet e përdorura në këtë Deklaratë Rrjeti kanë kuptimet e mëposhtme:

| | |
|---|---|
| **FTE (Forum Train Europe)** | Forum Europian për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor |
| **PSO** | Kontrate të Shërbimeve Publike |
| **IHA** | Infrastruktura Hekurudhore “Albrail” sh.p.k (IHA) |
| **AIH** | Administruesi Infrastruktures Hekurudhore |
| **OSS** | One Stop Shop |
| **RNE** | Rail Net Europe |
| **SETO** | Vezhguesi i Transportit per Europen Jug-Lindore |

# 2 KUSHTET PËR PËRDORIM TË INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

## 2.1 STRUKTURA LIGJORE

Kushtet për përdorim të Infrastruktures Hekurudhore te shoqerise koncensionare “Albrail” sh.p.k janë te përcaktuara në kontraten koncensionare te saj si dhe duke zbatuar :

- Kodin Hekurudhor te Republikes Shqiperise, ligji nr 142/2016 date 22.12.2016 dhe akteve nen/ligjore ne zbatim te tij.

## 2.2 KUSHTET PËR SHPËRNDARJEN E ITINERARIT TË TRENAVE

### 2.2.1 Kushtet e përgjithshme për shpërndarjen e itinerarit të trenave për lloje te vecantë.

AIH shpërndan itinerarin sipas kushteve sic janë të paraqitura në Shtojcen 2 te ketij Dokumenti.

Një lloj i caktuar itinerari mund ti shpërndahet aplikuesit duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) Për përdorimin dhe transit, aplikanti është:
   - i regjistruar në Republikën e Shqipërisë;
   - një organizatë biznesi ndërkombetare ku të pakten një anëtar jeton në Republikën e Shqiperisë;
b) Për perdorimin transit, aplikuesi eshte :
   - Nuk ka mundësi tranziti ne IH;
c) Për përdorimin nderkombetar aplikuesi është:
   - Një ndërrmarrje që ofron shërbime transporti në transportin e kombinuar nderkombëtar;
   - Një ndërmarrje që ofron transport të mallrave në trafikun ndërkombëtar në rrjetin hekurudhor Trans-European për transportin e mallrave;
   - Një ndërmarrje që ofron shërbime transporti në transportin ndërkombëtar të mallrave.

### 2.2.2 Aplikantët

Itineraret e trenave të IH mund ti shpërndahen aplikantëve – ndërmarrjeve ose organizatave te biznesit ndërkombëtar dhe/ose njësive të tjera ligjore nëse janë regjistruar në shtete anëtare te BE ose në rajonin e SEETO dhe kanë nevojë për transport pasagjerësh dhe/ose mallrash për shkak të interesit publik ose tregtar.
Shërbimet e transportit hekurudhor mund të ofrohen vetëm nga ndërmarrjet hekurudhore. Nëse aplikuesi nuk është një ndërmarrje hekurudhore atëhere duhet të paraqese një kontratë te lidhur me ndërmarrjen hekurudhore për ofrimin e shërbimeve të transportit hekurudhor.

Transportuesi hekurudhore ( Ndermarrja) duhet te plotesojë kushtet e meposhtme:

1. Të zotëroje një license të vlefshme të lëshuar nga autoriteti perkates liçensues i Republikes Shqiperise, ose nga një autoritet licensues i vendeve anëtare të BE ose SEETO.
2. Te paraqesë një marreveshje të firmosur për të drejtat dhe përdorimin e infrastruktures hekurudhore me Administruesin e IH shqiptare.
3. Te zoteroje çertifikaten e vlefshme te sigurise

### 2.2.3 Licensa ( Leje Veprimtarie )

Për të siguruar itineraret e trenave aplikanti duhet të paraqesë një license te vlefshme qe vërteton aftësinë e tij për të siguruar te gjithë ose lloje të vecantë të shërbimeve të transportit hekurudhor. Nëse aplikuesi nuk është një transportues hekurudhor, për të siguruar itineraret e trenave duhet të provojë se shërbimet e transportit do të kryhen nga një transportues hekurudhore me licensë të vlefshme.

Licensat e leshuara nga autoriteti liçencues jane te vlefshme ne Republiken e Shqiperise. Licensat e leshuara nga autoriteti licensues i vendeve anetare te BE ose SEETO jane gjithashtu te vlefshme.

Autoriteti liçensues, pese (5) vjet pas leshimit te licenses, do te leshoje ose do te shtrije vlefshmerine e licenses te ndermarrjeve hekurudhore te regjistruara ne Republiken e Shqiperise nese ato do te vazhdojne te plotesojne kushtet per pajisje me license sic eshte percaktuar ne Kodin Hekurudhor. Licensa e leshuar nga autoriteti liçensues është e vlefshme deri në anulimin e vlefshmërise së saj nese ka arsye, sic eshte percaktuar ne nenin 25 te Kodit Hekurudhor, ligji nr 142/2016 date 22.12.2016.

### 2.2.4 Certifikatat e Sigurisë

Per te siguruar itinerarin e trenave, aplikuesi duhet të paraqes nje certifikatë të vlefshme sigurie qe konfirmon kërkesat e specifikuara të plotesimit te sigurise së trafikut. Nëse aplikuesi nuk është nje ndërmarrje hekurudhore, për të siguruar itinerarin e trenave, ai duhet te provojë qe shërbimet e transportit në itineraret e kerkuara të trenave do te kryhen nga nje ndërmarrje hekurudhore qe zoteron nje certifikate sigurie te vlefshme.

Autoriteti i Sigurise do te leshoje një certifikate sigurie per aplikantin qe zotëron nje licensë te vlefshme nqs ai paraqet:

- Ka krijuar sistemin e tij te administrimit sigurise (SMS) ne perputhje me dispozitat e Kodit Hekurudhor, plotësimin e kerkesave te percaktuara ne kushtet teknike te nderveprimit (TSI), metodat e perbashkta te sigurise(CSM) dhe objektivat e perbashkta te sigurise (CST) dhe ne akte te tjera ligjore dhe nenligjore per te menaxhuar rreziqet dhe për te ofruar sherbime e transportit hekurudhor ne menyre te sigurte,
- Qe personeli pergjegjes per operimin dhe monitorimin e trenave ka kualifikimin e pershtatshem për te plotësuar rregullat e trafikut, garantojne siguri ne transportin hekurudhor dhe zoterojne licencat e çertifikatat e tyre te sigurise,
- Qe mjetet levizëse në vijat e hekurudhore të rrjetit hekurudhor publik në Republiken e Shqipërise plotësojne kushtet teknike te nderveprimit dhe kërkesat e përcaktuara në Kodin Hekurudhor, aktet ligjore e nenligjore te dale prej tij.

Vetëm certifikatat e sigurisë te lëshuara nga Autoriteti pergjegjes per sigurine hekurudhore ne Republiken e Shqiperise jane te vlefshme. Çertifikata e sigurise per Transportuesin hekurudhore eshte e perdoreshme brenda afatit te vlefshmerise se saj.

**Deri ne pajisjen me çertifikate sigurie te transportuesve hekurudhore sipas Kodit Hekurudhor Nr 142/2016, Administruesi i Infrastruktures Hekurudhore do te lejoje perdorimin e infrastruktures sipas udhezimeve shkresore te Ministrise Infrastruktures dhe Energjise.**

### 2.2.5 SIGURACIONI

Për të përfituar itinerarin e trenave, ndërmarrja hekurudhore duhet të paraqesë një deshmi e te qenit e aftë per mbulimin e pergjegjesive civile qe rezultojnë nga detyrime të tij për dëmet që shfaqen ne rast aksidenti dhe incidenti ne hekurudhe gjatë kryerjes së aktivitetit të tij në IH të zotëruar nga Republika e Shqiperise. Për të treguar plotësimin e këtij kushti, ndërmarrja hekurudhore duhet të paraqesë siguracionin nga kompanitë e sigurimit ose ndonjë dokument tjetër që tregon metodën ose aftësine për të mbuluar detyrimet për deme qe rrjedhin si pasoje e kryerjes se aktivitetit transportit ne IH të zoteruar nga Republika e Shqipërisë.

## 2.3 SI TË APLIKOSH PËR NJË ITINERAR TRENASH

Procedura e shperndarjes se itinerareve eshte pershkruar ne detaje ne kapitullin 4 te ketij dokumenti "Shperndarje e Itinerarit te Trenave ".

## 2.4 KUSHTET E PËRGJITHSHME TË BIZNESIT MBI PËRDORIMIN E INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE KONCENSIONARE “ALBRAIL” SH.P.K.

Kushtet e përgjithshme te biznesit mbi perdorimin e infrastruktures hekurudhore shteterore percaktojne te drejtat e pergjithshme dhe detyrat e Administruesit te IH si dhe transportuesit hekurudhore dhe jane pjese perberese e seciles kontrate mbi perdorimin e infrastruktures te nenshkruar nga Administruesi i IH.

Qëllimi IH dhe transportuesit hekurudhore si dhe te percaktoje kushtet e perdorimit te IH. Qellimi kryesor i kushteve te biznesit mbi perdorimin e infrastruktures hekurudhore koncensionare “Albrail” sh.p.k eshte te rregulloje marredheniet ndermjet Administruesit te IHA dhe transportuesit hekurudhor.

### 2.4.1 Marrëveshja kuader

Me iniciativen e tyre aplikanti dhe Administruesi i IHA mund te firmosin nje marrëveshje kuader duke përcaktuar kërkesen e aplikuesit mbi itinerarin e transportit për nje periudhe me te gjatë se periudha e vlefshmerise së orareve te trenave dhe mbi aftësine e Administruesve te IH për te plotësuar këto nevoja. Marreveshja kuader nuk do të percaktoje hollesisht itinerarin e trenave, por eshte planifikuar ne nje menyre per te plotesuar nevojat legjitime tregtare te aplikuesit per kapacitet infrastrukture.

Si rregull marrëveshja kuader lidhet për nje periudhe prej pesë (5) vitesh, e rinovueshme ne periudha te barabarta me kohezgjatjen fillestare. Administruesi i IH ne raste te veçanta per rinovimin akordon periudha kohore me te shkurtra ose me te gjata. Cdo periudhe me e gjate mbi pese vjet duhet te bazohet ne legjislacionin ne fuqi me ekzistencen e nje marreveshjeje apo kontrate tregtare ekzistuese, investimeve te vecanta ose risqe. Firmosja e marreveshjes kuader per nje periudhe pesembedhjet (15) vjete eshte e mundur vetem ne raste per sherbime qe perdorin infrastrukturen e veçante ne perputhje me nenet 49,50,51 te Kodit Hekurudhor, infrastrukturen qe kerkon investime te rendesishme dhe afatgjatë, kur kjo argumentohet si duhet nga kerkuesi i kapacitetit. Çdo periudhe me e gjate se pesembedhjet vjete eshte e lejueshme vetem ne raste te jashtezakonshme, ne veçanti kur ka investime afatgjate ne shkalle te gjere dhe kur investimet jane te mbuluar nga angazhimet kontraktore,perfshire nje plan shumevjeçar amortizimi. Per keto raste te jashtezakonshme marreveshja percakton karakteristika te detajuara te kapacitetit infrastrukturor, i cili do te sigurohet per kerkuesin per kohezgjatjen e marreveshjes kuader, e qe perfshijne shpeshtesine volumin dhe cilesine e rrugekalimeve te trenit.
Marrëveshja nuk do te perjashtojë mundësinë për tu përdorur IH nga aplikante të tjere ose për të tjera qëllime, por kur dy aplikues aplikojnë për të njëjtin itinerar, ai që ka firmosur nje

marreveshje kuader do te ketë avantazh. Marrëveshja kuader përmban saksione te nevojeshme ne lidhje me zgjidhjen ose anullimin e saj. Paraprakisht marreveshja kuader miratohet nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor.
Aplikanti që ka firmosur nje marrëveshje kuader me Administruesin e IH do te paraqese nje kerkese per shperndarje itinerari ne perputhje me kete marreveshje, brenda struktures kohore dhe metodave sic jane percaktuar ne piken 4.4 me titull “Formulari aplikimit per caktimin e itinerarit trenit” dhe do te firmosë gjithashtu nje kontrate mbi te drejtën dhe perdorimin e IH me Administruesin e IH për te perdorur infrastrukturën hekurudhore.

### 2.4.2 Kontratë Perdorimi (Shfrytëzimi)

Për te perdorur infrastrukturen hekurudhore ndermarrja hekurudhore duhet te lidhe nje Kontrate me Administruesin e IH (“Albrail”) mbi hyrjen dhe perdorimin e IH.

Transportuesi hekurudhor dhe Administruesi i IH do te percaktojë nje marrëdhenie te dyanshme me kete kontrate, e cila perfshin masa te pergjithshme, teknike dhe financiare , ne lidhje me sigurimin e kushteve teknike dhe te tjera te sigurise te trafikut hekurudhor dhe tarifat e shfrytezimit te infrastruktures hekurudhore.

Kontrata duhet te jetë e shkruar e firmosur dhe është e vlefshme për periudhen e orareve te se cilës është shperndare itinerari i trenave.

### 2.4.3 Shërbime ne objekte e impiante te tjera

Administruesi i IHA duhet te sigurojë të drejtë hyrjeje nga vijat e IH drejt objekteve, impianteve të tjera të infrastrukturës hekurudhore (lidhjet industriale, terminalet, sponte apo estakada shkarkimi, etj) për ndërmarrjen hekurudhore me itinerar të shpërndare. Keto shërbime quhen shërbime ndihmese dhe janë paraqitur në paragrafin 5.5 të Deklaratës së rrjetit. Ndërmarrja hekurudhore duhet të sigurojë shërbimet e sipër përmendura nga një kontratë e vecantë e firmosur me Administruesin e IHA kur jane ne vartesi te drejtperdrejte prej tij,ose nga operatori zoterues i ketyre impianteve te shërbimeve.

Sipas një kontratë të vecante bazuar në parimet e marketingut, Administruesi i IHP ose operatori i impiantit shërbimit mund te ofrojnë shërbime të tjera të paraqitura në paragrafin 5.3 dhe /ose shërbime shtesë të paraqitura ne paragrafin 5.4 te Deklarates se Rrjetit.

## 2.5 PERDORIMI I RREGULLOREVE TE TRAFIKUT

Rregullat e vlefshme të lëvizjes, te cilat duhet të zbatohen kur përdoret kapaciteti i infrastrukturës hekurudhore te Shoqerise koncensionare “Albrail” sh.p.k, rregullohen me rregulloren e shfrytezimit teknik te hekurudhes dhe akteve te tjera ne zbatim te Kodit Hekurudhor Nr 142/2016, te cilat mundet te sigurohen nepermjet AIH.
Adresa dhe kontakti janë dhene në pikën 1.8.

## 2.6 TRANSPORT I JASHTËZAKONSHËM

Leja e Administruesit, e cila përcakton metoden dhe kushtet e transportit si edhe kompensimin, kërkohet paraprakisht për transportin e jashtëzakonshem. Administruesi do të vendosë mbi masat dhe kushtet e transportit ne raste të jashtezakonshme jo me vonë se 15 dite pas paraqitjes se kërkesës.

Rregulloret teknike, përcaktimet e dergesave te jashtëzakonshme, kushtet për marrjen e lejes dhe metodën për percaktimin e kushteve te transportit jane te percaktuar ne legjislacionin kombetar, i cili rregullon transportin në raste të jashtëzakonshme të dergesave. Për cdo informacion shtesë duhet të kontaktohet me Administruesin e IH te shpallur ne piken 1.8.

## 2.7 TRANSPORTI I MALLRAVE TË RREZIKSHME




Mallrat janë konsideruar si të rrezikshme nëse ato janë shpallur si të tilla ne listën e mallrave te rrezikshme dhe janë pjese e Direktivave mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme (RID) . Me marrjen e Certifikates së Sigurisë ndërmarrja hekurudhore do të provojë që trasnporti me ane të mjeteve të levizshme Lokomotive në rrjetin e IHP dhe stafi i angazhuar i tij në operacione dhe monitorim e trenave që kryejnë transportin, plotesojne kushtet dhe janë përkatesisht të trajnuar mjaftueshem, sic eshtë përcaktuar ne Kodin Hekurudhor mbi sigurine e transportit hekurudhor dhe rregulloret e lëshuara nga ministria pergjegjese per transportin dhe infrastrukturen mbi transportin e mallrave te rrezikshme.

## 2.8 PERSHTATSHMERIA E MJETEVE LEVIZESE TE TRANSPORTUESVE HEKURUDHORE

Me marrjen e Certifikatës së Sigurisë transportuesi hekurudhore do të provojë me dokumente që mjetet levizëse në vijat e rrjetit hekurudhor Koncensionar “Albrail” plotësojne kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në Kodin Hekurudhor mbi sigurinë e transportit hekurudhor dhe

rregulloret e lëshuara ne zbatim te tij. Për cdo informacion shtesë mbi IH duhet të kontaktohet sipas kontaktit te shpallur ne piken 1.8.

## 2.9 STAFI I KUALIFIKUAR I TRANSPORTUESIT HEKURUDHOR

Duke ju referuar kerkesave te kualifikimit profesional te stafit te transportit hekurudhor, kompania “Albrail” sh.p.k ka ngritur nje strukture te kualifikuar dhe te mireorganizuar i cili garanton njohuri dhe eksperience e nevojshme per sigurine dhe kontrollin e transportit, te percaktuar ne kontrate dhe ne license.
Punonjesit e kompanise Albrail sh.p.k jane te pajisur me deshmite perkatese nga Autoriteti Sigurise Hekurudhor, sipas pozicioneve te punes ku punojne (stacioni i ngarkimit, transporti, mirembajta e IH, transporti hekurudhor, oficina hekurudhore).

## 2.10 TRANSPORTI I UDHETAREVE

Transporti i udhetareve në rrjetin hekurudhor Koncensionar “Albrail” nuk kryhet aktualisht, por eshte planifikuar per fillimin e transportit te pasagjereve. Ky transport eshte nje nga detyrimet e kontrates Koncensionare.

## 2.10 MENAXHIMI I IHA

Administruesi i Infrastruktures Hekurudhore, bazuar mbi një kontratë koncesionare të firmosur me Qeverine e Republikes së Shqiperise, menaxhon Infrastrukturen Hekurudhore ne administrimin e tij.
Për të menaxhuar Infrastrukturen Hekurudhore, Administruesi i Infrastruktures do te veproje sipas dispozitave te Kodit Hekurudhor dhe akteve nenligjore te dale prej tij. Infrastruktura hekurudhore Fier-Vlore dhe Fier-Ballsh menaxhohet nga shoqeria ALBRAIL shpk, nepermjet nje kontrate koncesioni te lidhur nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktures ne vitin 2016.

# 3. INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE

## 3.1 PËRCAKTIMI I INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

Infrastruktura hekurudhore e shoqerise Koncensionare (IH) përfshin linjat hekurudhore pajisjet dhe instalimet e nevojshëm për lëvizjet e mjeteve hekurudhore pa probleme dhe përfshin gjithashtu tokën korresponduese që i shërben ketij qellimi.
Infrastruktura hekurudhore është në pronesi të shtetit (e administruar nga IH) dhe e ndërtuar për përdorim publik sipas mënyres dhe kushteve te percaktuara ne Kodin hekurudhor Nr 142/2016 dhe sipas akteve nenligjore e rregulloreve të lëshuara ne zbatim te tij.

## 3.2 HAPËSIRA E SHTRIRJES SË IH

### 3.2.1 Përcaktimi gjeografik i IHA

Përcaktimi gjeografik i IH te Shoqerise Koncensionare “Albrail” paraqet përmbledhjen e zhvillimit të vijave hekurudhore kryesore dhe rajonale si një pjesë përberëse e IH në territorin e zones Koncensionare dhe përmbledhjen e mjediseve në keto vija. Te dhënat jane në tabelën 2.1, ndersa vijat dhe hartat e pasqyres se pergjithshme te stacioneve jane dhene ne Shtojcen 1/3 te Deklarates së Rrjetit.

Tabela 3.1: Pasqyra e pergjithshme e vijave kryesore dhe rajonale te IH

| **Vijat Kryesore** | | |
|---|---|---|
| **Nr.** | **Vija hekurudhore** | |
| **1** | Fier-Vlore | |
| **2** | Fier-Ballsh | |
| | | |
| | | |
| | | |
| **Vijat Rajonale** | | |
| **Nr.** | **Vija hekurudhore** | |
| **1** | - | |
| **2** | | |
| **3** | | |

**Vijat hekurudhore Fier – Vlore dhe Fier – Ballsh jane dhene me koncesion shoqerise ALBRAIL shpk per nje periudhe 25 vjecare.**
Sipas Kodit Hekurudhor Nr 142/2016 neni 109 linjat hekurudhore dhe pajisjet e lidhura me to, te cilat përfshihen ne rrjetin hekurudhor koncensionar jane :

- Linjat hekurudhore per sherbimet e mjeteve hekurudhore ,
- Linjat hekurudhore te degezimeve ne stacionet e trenave,
- Linjat e depozitimit te lokomotivave ,
- Linjat industriale dhe vijat hekurudhave ne brendesi të subjekteve private, shteterore, e portuale.

Tabela me të dhëna Teknike mbi vijat dhe stacionet në Shtojcen 3 përfshin një rishikim mbi kapacitetet e vijave dhe shfrytëzimin e tyre.

### 3.2.2 Rrjetet hekurudhore te vëndeve fqinje

Infrastruktura hekurudhore e Hekurudhes koncensionare “Albrail” eshte e lidhur ne fillimin e Stacionit hekurudhor Fier Km 84+100 dhe mbaron ne Vlore dhe Ballsh, pra nuk lidhet me vende fqinje.

Tabela 3.2: Lista e pikave te lidhjeve hekurudhore

| **Kodi i lidhjes ne kufi** | **Emri i lidhjes ne kufi** | **Simbolet e lidhjes mes vendeve** | **Lloji i lidhjes ne kufi** |
|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** |
| - | | | |

## 3.3 PËRSHKRIMI I IH

### 3.3.1 Karakteristikat Teknike të IH

Nje pasqyre e pergjithshme e linjave (binareve) dhe stacioneve tregohet ne Shtojcen 1 te ketij dokumenti. Ndërrueset dhe nyjet hekurudhore në itinerarin e trenave janë pjesë e linjave të përshkruar në Shtojcen 1.
Funksionimi i qarkullimit trenave nuk është i rregulluar aktualisht me mjete sinjalizimi elektrik por me një sistem radio komunikimi. Një pasqyrë e përgjithshme e sistemit aktual dhe procedurat janë treguar në Shtojcen 1 të këtij dokumenti.

#### 3.3.1.1 Llojet e vijave

Sipas volumit të trafikut dhe rolin e ndërsjellte në trafikun hekurudhor vijat hekurudhore ndahen :

- Kryesore

Të gjitha vijat hekurudhore janë aktualisht linja njefish ( nje e vetme, ku trenat lëvizin në të dy drejtimet në të njëjten linje)
Lloje te vijave sipas numrit të shinave:

| Lloji i vijave | Linje njefishe | Linje dyshe | Total |
|---|---|---|---|
| Kilometra | 35.390 km | 0 km | |
| Ne perqindje | 100 % | 0 % | 100 % |

#### 3.3.1.2 Hapesira midis shinave

Gjeresia midis shinave eshte distanca me e vogel midis anes se brendshme te shinave funksionuese brenda mases prej “0” dhe “14” mm poshte siperfaqes se rrafshet te pjeses se siperme te te dy shinave . Vijat hekurudhore, te cilat jane pjese e IH te HSH, kane nje hapesire te shinave prej 1435 mm.

#### 3.3.1.3 Stacionet dhe nyjet

Karakteristikat teknike dhe distancat midis stacioneve dhe nyjeve te IH jane dhene ne tabelen e te Dhenave Teknike mbi vijat dhe stacionet ne Shtojcen 1.

### 3.3.2 Limitet e IHA

#### 3.3.2.1 Profili i Hapesires se Lire

Profili i hapesires se lire njihet si nje hapesire specifike te lire nga linjat (binaret), objektet, sinjalet, materialet e depozituara dhe objekte te tjera. Profili normal dhe minimale te hapesires se lire jane te rendesishme. Permasat e ketyre profileve jane te vlefshme për vijat e drejta dhe te kurbezuara me $R \geq 250$ m. Tipe te rendesishme te profileve te hapesires dhe detaje te tjere jane treguar grafikisht ne Shtojcen 1 te ketij dokumenti.


REDMI NOTE 9 PRO
AI QUAD CAMERA


770 526-2

Profili normal i hapësires lire merret ne konsiderate kur mirembahen dhe modernizohen vijat ekzistuese. Profili normal i hapesires eshte zona e rezervuar per mjetet e transportit hekurudhor qe levizin duke marre parasysh lekundjet horizontale dhe vertikale, tolerancen per shine dhe zonat shtese A dhe B, ku, nen kushte speciale, mund te gjenden objekte te caktuara, material i depozituar dhe mjete te qendrueshme.

Pjesa me e vogël e hapësires eshte e njejte per gjithe profilet dhe tregohet veçmas per detaje qe duhen theksuar. Profili minimal i hapesires merret ne konsiderate kur seksione te ndare te vijave ekzistuese si profili i hapesires me i vogel i mundshem jane mirembajtur dhe modernizuar. Informacioni shtese mbi mundesine e perdorimit te profilit minimal te hapesires eshte ne dizpozicion nga Administruesi i IH (kontaktet jepen ne piken 1.8).

Standartet e ngarkeses GA, GB1 dhe GB2 jane te pranueshem ne gjithe vijat dhe stacionet.

#### 3.3.2.2 Ngarkesat e lejueshme per aks dhe per meter linear

Ngarkesa e lejuar per aks eshte 20,5 ton .Ngarkesa e lejuar për aks eshte sasia maksimale per ton e cila mund te ngarkohet ne nje aks te mjetit hekurudhor ne nje vije te caktuar ose itinerar pavaresisht numrit total te tij te akseve.
Ngarkesa e lejuar për meter linear eshte sasia maksimale ne ton e cila mund te ngarkohet ne nje meter linear te mjetit hekurudhor ne nje vije te caktuar ose itinerari.
Nje pasqyrë e përgjithshme e ngarkeses se lejuar për aks dhe meter është në tabelën ne Shtojcen 1 te këtij dokumenti.
Ne përgjithesi te gjitha vijat hekurudhore janë (UIC) kategoria C4.

#### 3.3.2.3 Menaxhimi i pjerrësive dhe rezistenca e lëvizjes në vijat e IH

Gradienti kryesor (vendimtar) i vijes eshte ngritja ose ulja maksimale e binareve te treguar ne nje te mijte (%) dhe eshte baze per percaktimin e perqindjes se frenimit, llogaritjen e kohes se levizjes, ngarkesen per lokomotiven etj
Rezistenca vendimtare (thelbesore) e hekurudhes eshte gradienti vendimtar i hekurudhes i treguar ne daN/t (Deca Newton/ton) ku vijat ne kthese dhe rezistenca neper tunele shtohen. Nje pasqyre e pergjithshme e gradienteve kryesore (vendimtare) dhe rezistences ne vijat e veçanta jepet ne Shtojcen 1 te ketij dokumenti.

#### 3.3.2.4 Shpejtësia per vije

Nje pasqyre e pergjithshme e shpejtesise per vijat hekurudhore ne vijat e IHA tregohen ne Shtojcen 1 te Deklarates se Rrjetit.

#### 3.3.2.5 Gjatësia maksimale e vijave ne stacione:

Gjatësia e vijave dhe gjatësia e vijave në përdorim janë treguar ne tabelën ne Shtojcen 1 te Deklaratës së Rrjetit.

#### 3.3.2.6 Kodifikimi i vijave per transport te kombinuar

Njësite e transportit Intermodal ( ITU – kontenierët, njesite e shkëmbimit, etj.), të transportuar ne IH, i përkasin kategorisë së dërgesave të jashtëzakonshme me një procedurë speciale (njoftim mbi transportin, lloi i ngarkeses, permasat maksimale, pesha, përftimi i marrëveshjes së përshtatshme nga gjithë administruesit e infrastruktures në vijat e transportit, etj.). Për të shmangur kushtet e transportit të komplikuar për ITU e standartizuara, është paraqitur një sistem kodifikimi për transportin e kombinuar, duke përcaktuar se cila ITU me karakteristika

specifike teknike mund të transportohet në një vije të caktuar. Kodifikimi i ITU rregullohet nga skeda UIC 596 – 6.
Shtojca 1 (pamja 2/2.9) tregon sistemin e kodifikimit të vijave për transport të kombinuar ne vijat e IH. Kodi C përdoret për njësite e shkëmbimit dhe kodi P per gjysem – rimorkiot.

### 3.3.3 Kontrolli teknik i trafikut dhe sistemet e komunikimit

- Siguria ne stacione
  - Pajisje elektronike të sinjalistikes nuk janë te përdorshme.
  - Pajisjet elektronike te sinjalistikes se ndërrimit nuk janë te përdorshme
  - Pajisjet elektro –mekanike te sinjalistikës nuk jane te perdorshme.
  - Pajisjet mekanike te sinjalistikës jane te përdorshme.
  - Pajiset e sinjalistikës së kombinuar nuk jane të përdorshme.
- Siguria ne kalim ne nivel
  - Siguria e kalimeve ne nivel :
    - Siguria e kalimeve ne nivel automatike ose elektrike
      - Jo ne dizpozicion
    - Siguria mekanike e kalimeve ne nivel
      - Eshte e dispoueshme
    - Metodat e sigurise :
      - Barrierat
      - Gjysme barrierat, nuk jane te aplikueshme
      - Sinjalet Rrugore elektrike, nuk jane te aplikueshme
  - Kalimet ne nivel jo aktive te siguruara, te shenuara me sinjalistike te trafikut rrugor. Jane te aplikueshme.

- Mbyllja automatike e hekurudhes - ARB
  Siguron mbrojtje të plote të trenave pasues ne një vije te hapur midis dy stacioneve . Nuk përdoret në Shqipëri.
- Sistemet e mbylljes
  ARB i thjeshtezuar per te kontrolluar disponueshmerine dhe sigurine ne gjithe vijen midis pjeseve te stacioneve. Nuk eshte e disponueshme.
- Kontrolli ne distance i trafikut (RTC) ose i telekomanduar (Tco)
  Kontrolli aktiv ne distancë dhe menaxhimi i trafikut në një vije të përcaktuar ose nyje nga pjesa qëndore. Nuk eshte e disponueshme.
- Pajisjet Autostop – ASD
  Ndalesat automatike të trenave në rast të stacioneve të pakontrolluara ose sinjalistikes. Nuk është i disponueshëm ne IH.
- Informim me lidhje me radio – RDC
  Kontaktet direkte midis drejtuesve të levizjes me makinistët. Nuk është e disponueshme ende në Shqipëri.
  Sistemi me radio siguron lidhjet midis dispeçerit qëndror dhe atyre në stacione. Leja për lëvizje i jepet makinistit te trenit në çdo stacion me format leje nisjeje e shkruar dhe nenshkruar nga drejtuesi i levizjes se trenave i stacionit hekurudhor.

#### 3.3.3.1 Pajisjet e sinjalistikës dhe te sigurisë

Pajisjet e sinjalistikës dhe te sigurisë janë sinjale me drita ose shenja përgjate vijes që lidhen me qëndren dhe me pajisje të tjera pergjate rruges qe kryen treni. Sinjalet përdoren per te komunikuar makinisti me stafin e menaxhimit te trafikut hekurudhor. Ata tregojne sinjale për lejim ose ndalim të lëvizjes se trenave dhe sinjale per lejim kalimi me shpejtesi te rregulluar ose te reduktuar ne varesi te pozicionit dhe gjeometrise se vijes, llojit te itineratit, ( linjë e drejtë ose e devijuar), situatës së trafikut etj.

Sinjalet aktuale me dritë nuk jane të dizponueshme në IH**. Makinisti duhet të lëvize trenin nga njëri stacion në tjetrin nepermjet lejes e urdhrit me shkrim te leshuar nga drejtuesi i levizjes i stacionit (inspektori i sherbimit ).** Sinjalistika me shënja për vendet e ndalimit ose frenimit ne stacione ekzistojne, por ka dhe mungesa.

#### 3.3.3.2 Kontrolli teknik i menaxhimit te trafikut

Eshte i aplikueshem, nepermjet zyres se menaxhimit te trafikut.

Grafiku i Levizjes se trenave (Orari i Nisjes/Mbrritjes te trenave) do te publikohet ne Deklaraten e Rrjetit kur te filloje sherbimi i udhetareve ne Fier-Vlore me tren. Aktualisht, Abrail mirepret kalim trenash nga te trete, perfshi dhe HSH ne cdo kohe 24/7 ne Zonen Koncesionare dhe pershtat trenat e saj ne perputhje me kerkesat e te treteve per kalim ne Infrastrukture.

#### 3.3.3.3 Sistemet Telekomunikacionit

- Shoqeria koncensionare.
- Sistem publik i adresave ne stacione :nuk eshte ne dizpozicion
- Pikat e telefonatave / paisjet e telefonave per makinistet: jane ne dizpozicion
- Telefonat ndihmes per situatat emergjences: jane ne dizpozicion; mund te perdoret edhe sistemi i informimit me radio.
- Ne te ardhmen e afert, do te kete ne dispozicion edhe regjistrator per regjistrimin e bisedave ne vijat hekurudhore, per komunikimet me radio, apo telekomunikimet e drejtuesve te levizjes trenave ( inspektori i sherbimit ) e stacioneve hekurudhore.

#### 3.3.3.4. Lidhjet nepermjet njoftimeve me radio

Lidhjet nëpërmjet njoftimeve me radio (**RDC**) u krijuan vecanërisht për hekurudhat, dhe ato lejojne komunikim të vazhdueshëm midis trenit (lokomotives) dhe qëndrës së dispecerave ne pjesë te caktuara të itinerarit të trenit. Ato paraqesin instrumentat e arsyeshëm dhe të nevojshëm për menaxhimin e trafikut hekurudhor. Për shkak të nderhyrjes direkte ne të dy drejtimet lidhja nëpërmjet njoftimeve me radio paraqet nje plotësim të sinjalistikës aktuale hekurudhore dhe pajisjeve te sigurisë dhe një rritje në sigurinë e përgjithshme të lëvizjes.

Nuk është e disponueshme në IH te Albrail shpk.

## 3.4 KUFIZIMET NE TRANSPORT

Kufizimet ne transport mund ti referohen kryesisht si vijon:
- Bllokimi i IH ;
- kufizimet nga mjedisi;
- transporti i mallrave te rrezikshme;
- kufizimet ne tunele;
- kufizimet ne ura;
- kufizime te tjera.

### 3.4.1 Bllokime te infrastrukturës

Ne infrastrukturen hekurudhore Koncensionare “Albrail” sh.p.k jane keto dy lloje bllokimesh:
Ka bllokime te perhershme te infrastruktures ne linjen Fier-Ballsh. Bllokimet e perhershme jane vijat ku mbizoteron gjendja teknike jo e mire e infrastruktures hekurudhore dhe jane te lidhur me nevojen per nderhyrjen e permiresimit te infrastruktures.
Bllokime te perkohshme ka ne linjen Fier-Vlore. Bllokimet e perkohshme qe kane lidhje me transportin momental te mallrave dhe pasagjereve dhe kerkojne zgjidhje operative.

### 3.4.2 Kufizimet e Mjedisit

Kompania Koncensionare Hekurudhore “Albrail “qe ka siguruar sherbime ne Republiken e Shqiperise zbaton rregullat mjedisore:

- Ka nenshkruar kontrate me kompani te licensuar dhe dorezon raporte vete-monitorimi te gjendjes e mjedisit cdo gjashte muaj prane Agjencise Kombetare te Mjedisit,
- Vezhgon dhe zbaton te gjitha rregullat e nevojshme per te parandaluar dhe reduktuar ndotjen e mjedisit,
- Ka marre te gjithe masat e nevojshme per te parandaluar dhe reduktuar ndotjen e mjedisit, dhe derdhjet e tyre ne ambjent nuk duhet te kalojne limitet e keshilluara.
- Ne rast se ndodh nje incident mjedisor, informon menjehere autoritetet pergjegjese dhe merr te gjitha masat e nevojshme per te reduktuar pasojat demtuese te mjedisit.

Kufizimet e mjedisit ne lidhje me transportin hekurudhor, te cilet duhet te plotesohet kur ofrohet transport hekurudhor, jane te percaktuara ne :

- Ligji nr 10431 date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”;
- Aktet nenligjore ne zbatim te ligjit per mbrojtjen e mjedisit.

### 3.4.3 Transporti i mallrave te rrezikshme



Mallrat quhen si të rrezikshme nëse ata janë deklaruar në listën e mallrave të rrezikshme dhe janë pjesë e Direktivës mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme (RID). Me marrjen e certifikatës së sigurisë, ndërmarrja hekurudhore do të provojë se transporti me anë të mjetit lëvizës në rrjetin e IH të Shoqerise Koncensionare “Albrail” SH.P.K dhe nga personeli i saj, i caktuar në perdorimin dhe mbikqyrjen (monitorimin) e trenave, kryerjen e transportit, respekton kushtet dhe janë trajnuar në mënyrën e duhur përkatësisht, siç përcaktohet nga Kodi Hekurudhor Nr 142/2016 dhe akteve nenligjore te nxjerra në bazë të tij për sigurinë e transportit hekurudhor.

### 3.4.4 Kufizime ne tunele

Kufizimet në tunele në lidhje me përmasat e hapësirës së vagonëve të vecantë ne një tren jepen per dërgesa me transport të kombinuar ose te veçante qe tejkalojne permasat normale.
Kufizimet e hapësires, te përcaktuara nga profili i hapësires se lirë, jane shpallur në Shtojcen 1 te këtij dokumenti.

### 3.4.5 Kufizimet ne ura

Kufizimet për vagonë ose trena në lidhje me urat janë marrë parasysh në ngarkesat e lejuara për aks dhe ngarkesat për meter gjatësi ( linear ) treguar ne Shtojcen 1 të këtij dokumenti.

### 3.4.6 Kufizime të tjera

Një listë e mjediseve ku janë ndërprerë shërbimet jepet në Shtojcen 1 te këtij dokumenti. Administruesi i IH eshte përgjegjës për të dhene te gjitha kufizimet e tjera për shkak të dëmtimeve të infrastrukturës ( kontaktet jepen ne pikën 1.8 ).

## 3.5 REZERVIME NE INFRASTRUKTURE

Administruesi i IH , gjatë pregatitjes së orarit për rrjetin ne administrim te tij, do të marre në konsiderate dhe do të tregojë në seksione të ndarë hekurudhore kohën e rezervuar, periudhën e mirëmbajtjes, riparimin ose rikonstruksionin, si edhe kuadrin kohor dhe itinerarin e trenave të rezervuar për mirëmbajtjen e vijave, riparimin ose rindërtimin e IH.

## 3.6 STACIONET E UDHETAREVE

Stacionet e udhetareve jane ne proces rikonstruksioni por nuk jane akoma te hapura per udhetare. Brenda nje afati te caktuar ne kontrate, Koncensionari do te vendose ne dipozicion te udhetareve trenin e pasagjereve Fier-Vlore.
Stacionet e Infrastruktures Hekurudhore Koncensionare “Albrail” jane:
1- Fier, Novesele dhe Vlore.
Në stacionet e hapura për transportin e udhetareve, e drejta dhe përdorimi i platformës, duke përfshire gjithë rrugët e tjera publike lidhëse drejt transportit të pasagjereve me trenat e pasagjereve është e lejuar. Informacioni për pasagjeret duke përdorur sistemin e adresave dhe sistemin pamor të informacionit mbi mbërritjet dhe nisjet e trenave ose ndonje te dhëne tjetër është gjithashtu i përfshire.

Lista e stacioneve, duke përfshire të dhënat mbi gjatësine e platformës, është në Shtojcen 2 të Deklarates së Rrjetit.
Shtojca 1/3 tregon planet skematike te stacioneve të vecanta, kategorizimin e stacioneve dhe ndalesave të vecanta.

## 3.7 TERMINALI I MALLRAVE

Lista e gjithe stacioneve të hapura për të pranuar dërgesat e vagonave të mallrave jepet në Shtojcen 1 të Deklarates së Rrjetit. Terminalet e paraqitura garantojnë kapacitetin e linjave për të kryer ngarkim- shkarkim dhe ringarkim të mallrave.

**3.7.**1 Stacionet, të përcaktuar vetëm për formimin e trenave ( marshalling yards ) :
**Asnjë**

3.7.2 Stacionet, ku ngarkimi dhe shkarkimi i mjeteve personale është i mundur:
**Asnjë**

**3.7.3** Stacion, i hapur per levizje rruge-hekurudhe
**Asnjë**

**3.7.4** Stacione me terminal kontenieri
**Asnjë**

### 3.8 AKTIVITETI I SHERBIMIT

Në disa stacione te IH, Administruesi lejon përdorimin e impianteve të shërbimit dhe pajisjeve si një shërbim shtesë te IH.
Lista e impianteve dhe pajisjeve sherbimit, përdorimi dhe cmimet jepen ne Shtojcen 2/1 te Deklarates se Rrjetit.

#### 3.8.1 Peshoret hekurudhore :

Tabela 3.3: lista e stacioneve, ku ka peshore hekurudhore :

| **Kodi** | **Stacioni** | **Kapaciteti i ngarkeses ne ton** | **Gjatesia ne meter** |
|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **4** | **5** |
| 00001 – 8 | Fier | 4x120 | 14 |
| 00006 – 7 | Vlore (PIA) | 120 | 13 |
| 00013 – 3 | Ballsh | 120 | |

**Peshoret ndodhen ne stacionet e ngarkimit te naftes bruto Drize dhe ne PIA Vlore (peshoret ne PIA Vlore menaxhohen nga vete PIA).**

#### 3.8.2 Stacioni i ngarkimit te naftes bruto ne qytetin e Fierit ne Drize.

Stacioni Hekurudhor i Ngarkimit te Naftes Bruto, ndodhet ne qytetin e Fierit ne Drize,para Uzines se Rafinerise se Naftes. Fillon nga mbikalimi i Rruges auto Fier-Vlore (Qafa e Koshovices), Km 87+300 dhe mbaron 87+700 (ne Porten Hekurudhore te Rafinerise).

Lidhet me Stacionin Hekurudhor Fier dhe rrjetin hekurudhor kombetar nepermjet Degezimit Hekurudhor, me gjatesi 1700 metra. Eshte i ndertuar rishtaz si investim i ri me Usekun e Zhupanit.

Stacioni i Ngarkimit te Naftes, perbehet nga dy vija hekurudhore paralele, me gjatesi reth 370 ml dhe dy nderruese (tip 1:9 R180 S49). Binari hekurudhor i rehabilituar, eshte me shina te mesme S42, me betoni ( ne kthesa druri), me balast cakelli, me aftesi mbajtese 20,5 ton per aks.

Pershkrimi i teknologjise se punes, levizjes dhe ngarkimit ne stacionin e ngarkimit.

Per vete llojin e produktit qe transportohet-nafte bruto, produkt hidrokarbur i lengshem dhe i rende, transporti kryhet vetem me trena te specializuar, te kompozuar me vagone special dhe lokomotiven terheqese te tipit T 770, te destinuar enkas per kete qellim. Treni pervec Lokomotives, sipas rastit eshte me 8, 10 dhe 12 vagone. Keta vagone jane me nga 4 akse, te tipit 1462 dhe 1463, tanker (cisterno), me veshje speciale termoizoluese dhe me pajisje ngrohese te naftes bruto, te gatshme per te funksionuar, ne rast kur do te nevojitet.

Stacioni Hekurudhor i ngarkimit te naftes bruto-Drize (prane rafinerise ), eshte objekt i ndertuar krejtesisht i ri dhe i pajisur me teknologji moderne (prodhim perendimor i vitit 2018), per ngarkimin dhe peshimin e vagoneve hekurudhor. Menjehere pasi perfundon ngarkimi, njekohesisht behet peshimi, sepse vagoni ngarkohet i pozicionuar mbi peshoren hekurudhore dhe del automatikisht flete-pesha. Ketu behet monitorimi i trenit gjate gjithe procesit.





Ne stacion jane instaluar dy linja hekurudhore paralele standarte, me distance aksiale 8,2 metra te lidhura me dy nderruese per qarkullim te levizjes hekurudhore. Ne keto linja hekurudhore jane te instaluara ne piketen, Km 87+580 metra (pikerisht ne vendngarkimin e vagoneve), 4 peshore elektronike hekurudhore te kapacitetit 120 ton, ne kuoten 0-zero, nen konstruksionin metalik, ne secilen ane, nga 2 peshore. Keto jane te pajisura me shina hekurudhore, qe mundesojne direkt, peshimin e vagonit ne postin e ngarkimit. Pra jane instaluar 4 peshore dhe pikerisht mbi to jane instaluar ne konstruksion, 4 krahet e ngarkimit te naftes.
I gjithe ky kompleks eshte mbi nje konstruksion te fuqishem metalik te mbuluar ku jane instaluar te gjitha sistemet e komandimit , sigurise dhe monitorimit.



Stafi i stacionit te ngarkimit eshte i trajnuar, i pajisur me veshje e mjete mbrojtese speciale, qe me vete mbajne gjithmone detektorin qe sinjalizone pranine e gazit sulfuor. Punonjesit zbatojne me perpikmeri rregulloren dhe kane procedure rigoroze standarte, ne pozicionimin e vagonit, ngarkimit dhe levizjen e vagoneve pas ngarkimit.

### 3.8.3 Pajisje të pastrimit të akullit:

**Asnje**

### 3.8.4 Parku i Lokomotivave:

Parku i lokomotivave gjenden prane stacionit Fier, qe ndodhet prane stacionit hekurudhor:

- Fier

#### 3.8.5 Mirëmbajtja teknike

Mirëmbajtja teknike e mjeteve hekurudhore behet ne Oficinen prane stacionit Fier dhe Njesine e Sherbimeve Mjeteve Levizese te HSH, dhe ndodhet prane stacionit hekurudhor:

- Fier
- Shkozet, Durres

#### 3.8.6 Stacionet e furnizimit me karburant:

Stacioni i furnizimit me karburant te lokomotivave ndodhet prane stacionit hekurudhore :

- Fier

### 3.9 ZHVILLIMET E INFRASTRUKTURES

Projektet e zhvillimit mbi infrastrukturën hekurudhore koncensionare “Albrail” janë te percaktuara ne kontraten koncensionare te kompanise Albrail me Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise.
Referuar kesaj kontrate kompania Koncensionare ka zbatuar pikat e kontrates duke modernizuar dhe mirembajtur infrastrukturen hekurudhore Fier-Vlore, ndersa ka kerkuar rishikimin e projektit “Rehabilitimi i infrastruktures hekurudhore Fier-Ballsh”.

## 4 SHPERNDARJA E ITINERAREVE TË TRENAVE

Aplikantët që përmbushin termat e përcaktuar në seksionin 2.2 mund të marrin pjesë në proçedurën për alokimin e itinerarit të trenit.

### 4.1 KUADRI LIGJOR

Proçedura e alokimit të itinerarit të trenit rregullohet nga Kodi Hekurudhor i Republikes Shqiperise ligji nr 142/2016 date 22.12.2016 dhe rregulloret ligjore ne fuqi.

### 4.2 PERSHKRIMI I PROÇEDURES

Parimet e mëposhtme do të merren në konsideratë në proçedurën e shperndarjes se itinerarit të trenit:

- Parimi i konkurimit neutral,
- Parimi i përdorimit efektiv të Infrastrukturës Hekurudhore dhe
- Parimi i transparences (drejtesise) dhe mos diskriminimit.

•E gjithë proçedura do të bazohet në parimin e konkurimit neutral, që nënkupton trajtimin e barabartë të kërkesave të të gjithë aplikantëve, në mënyrë që alokimi i itineraréve të duhur të trenave të bëhët mbi bazën e efiçencës dhe përfitimit ekonomik. Në rastin e kërkesave konfliktuese, i jepet prioritet nevojave me interes publik.

•Përgjatë gjithë proçedurës do të garantohet parimi i përdorimit efektiv të Infrastrukturës Hekurudhore. Orari i rrjetit do te të përgatitet në përputhje me përdorimin më të mirë të burimeve nga ana e aplikuesve në lidhje me përdorimin optimal të IH.

•Gjatë proçesit të marrjes së vendimit mbi kërkesat e paraqitura AIH do të veproje në përputhje me parimin e drejtësisë dhe mos diskriminimit dhe kështu që do të trajtohen pa asnjë lloj diferencimi kërkesat e paraqitura për alokimin e itinerarëve të trenit.

## 4.3 AFATI KOHOR PER KERKESAT DHE ALOKIMIN E ITINERARIT TË TRENIT

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për alokimin e itinerarit të trenit për çdo përiudhë oraresh ne veçanti brenda një afati kohor dhe një mënyre të përcaktuar në seksionin 4.3.1. Gjatë vlefshmërisë së orarit, herë pas here mund të paraqiten kërkesa për alokimin e itinerarit të trenit brenda afatit kohor dhe metodës së përcaktuar në seksionin 4.3.2.

### 4.3.1 Kërkesat ne oraret e rregullta për itinerarin e trenit

•Kërkesa të paraqitura në kohë për alokimin e itinerarit të trenit për periudhën kohore te orarit punes 2025/2026 konsiderohen ato të paraqitura me shkrim prane IHA, me anë të e-mail-it ose me shkrim jo më shume se 12 muaj para hyrjes ne fuqi te orarit punes (mesnata e te shtunes se dyte te muajit dhjetor 2025).
•Një kërkesë për alokimin e itinerarit të trenit për një tren ndërkombëtar, të cilën aplikanti e dorëzon në kohën e duhur pranë një menaxheri të huaj infrastrukture, do të konsiderohet si një kërkesë në kohën e duhur nëse këto kërkesa i bëhen me dije AIH nga menaxheri i huaj i infrastrukturës në emër të aplikuesit, brenda afatit kohor jo me vone se 11 muaj para se te hyje ne fuqi orari i punes.
•Jo me vone se 11 muaj para se te hyje ne fuqi orari i punes, administruesit e infrastrukturave sigurojne qe rrugekalimet e perkoheshme nderkombetare te trenave te jene krijuar ne bashkepunim me administruesit e tjere te infrastruktures perkatese. Administruesit e infrastruktures sigurojne qe keto zbatime te respektohen sa me shume gjate proçeseve te mevonshme.
•Një kërkesë për alokim itinerari treni për një itinerar ndërkombëtar të paraqitur nga vetë aplikanti ose nga menaxheri i infrastrukturës së huaj në emër të tij, e deklaruar në konferencën ndërkombëtare të trenave, që mblidhet për përgatitjen e një orari të ri për periudhën kohore të kësaj Deklarate Rrjeti do të konsiderohet si një kërkesë e paraqitur në kohë për një itinerar ndërkombëtar treni.

### 4.3.2 Kërkesa e rastit (Ad hoc) për itinerare treni në një afat të shkurtër kohor

Nëse aplikantët kanë nevojë urgjente për një itinerar treni, ata munden brenda vlefshmërisë së orarit të rrjetit, të paraqesin një kërkesë me shkrim ad hoc për itinerar treni ose me e-mail. Kërkesa ad hoc për alokim itinerari treni paraqitet pranë AIH.
AIH do të vendos mbi alokimin e itinerarit të trenit sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas marrjes së kërkesës, dhe do të informoj aplikuesin me shkrim ose me anë të e-mail-it.
Itinerari i trenit i alokohet aplikantit mbi bazën e kërkesës ad hoc nëse është e mundur dhe mbi bazën e parimit qe një kërkesë ad hoc e marrë e para ka avantazh mbi kërkesat e tjera ad hoc të dorëzuara më vonë. Informacioni mbi sistemet e mundshme të itinerarëve të trenave te paperdorura është i disponueshëm nga ana e Administruesit të IH për të gjithë aplikantët.

## 4.4 FORMULARI APLIKIMIT PËR ALOKIMIN E ITINERARIT TE TRENIT

Itinerarët kombëtar dhe ndërkombëtar të trenave kerkohen nga aplikanti me anë të dorezimit te AIH e një aplikimi ne forme kërkese për alokimin e itinerarit të trenit.

### 4.4.1 Organi kompetent

Administruesi i IH është organi kompetent.

#### 4.4.1.1 Aplikimi i plotësuar

Administruesi i IH trajton vetëm aplikimet e plotësuara për alokimet e itinerarit të trenit të paraqitura në kohë nga aplikantët e huaj ose vendas, ose menaxherët e huaj të infrastrukturës hekurudhore. Në mënyrë që të konsiderohen të plotë aplikimet duhet të plotësohen sipas formatit të paraqitur në Shtojcën 2/1 dhe të shoqëruara me të gjithë evidencat e nevojshme që të provojnë që aplikuesi përmbush kërkesat e përcaktuara në seksionin 2.2 të këtij dokumenti.

Nëse aplikuesi dorëzon ne kohe një kërkesë të paplotë ose të paqartësuar mirë, AIH duhet ta ftoje ate me shkrim ose me anë të e-mail-it, qe të plotësoje kërkesën brenda një afati kohor prej 5 ditësh pune nga marrja e ftesën; përndryshe një kërkesë e tillë nuk do të shqyrtohet gjatë proçedurës së alokimit të itinerarit të trenit.

#### 4.4.1.2 Konfidencialiteti i informacionit

Gjithë informacioni i deklaruar nga aplikantët në kërkesën për alokimin e itinerarit të trenit është konfidencial dhe administruesit IH nuk i lejohet t’ia jap këtë informacion përsonave të tretë ose ta përdor për qëllim tjetër, përveç se kur kjo është e nevojshme në kuadër të zbatimit të proçedurës së alokimit.

#### 4.4.1.3 Përcaktimi i grupeve të itinerarëve ndërkombëtar të trenit

Në konferencën ndërkombëtare të itinerarit të trenave brenda organizatës së Forumit Evropian për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor ( Forumi i Trenit Evropian – FTE) dhe RailNetEurope (RNE), administruesi i IH kordinon me menaxherët e huaj të infrastrukturës dhe aplikantët e tjerë lidhur me itinerarët ndërkombëtar të trenave dhe bashkarisht përcaktojnë grupet e itinerarëve ndërkombëtar të trenave.

Administruesi i IH bie dakort me përcaktimin e një grupi specifik itinerari ndërkombëtar treni, nëse aplikanti që paraqet kërkesën përmbush kushtet për alokimin e itinerarit të trenit i pëcaktuar në seksionin 2.2 të këtij dokumenti.

Nëse për një grup të veçantë itinerari ndërkombëtar treni nuk paraqitet asnjë kërkesë, AIH e rezervon itinerarin e trenit si ndërkombëtar në përputhje me marrëveshjen e bërë me menaxherët e tjerë. IHP mund ta ofroj itinerarin ndërkombëtar të rezervuar si një zëvendësim për një itinerar kombëtar treni nëse asnjë aplikant nuk paraqet kërkesë për të dëri në përfundim të proçesit të konsultimit.

Shënimet nga konferencat ndërkombëtare per itineraret e trenave brenda FTE dhe RNE përbëjnë bazën për alokimin e një itinerari ndërkombëtar treni nga administruesi i infrastrukturës të cilit i është paraqitur kërkesa për alokimin e itinerarit të trenit.

#### 4.4.1.4 Drafti i orarit të rrjetit

Administruesi i IHA, do të përgatisë një orar në formë drafti mbi bazën e kërkesave të plotësuara për alokimin e itinerarit të trenit të paraqitura në kohë, jo më vonë se 30 Qershor 2025 në përputhje me proçedurën dhe metodën e vlerësimit të kritereve për alokimin e itinerarit të trenit të përcaktuara në Shtojcën 2 duke marrë parasysh edhe grupet e përcaktuara të itinerarëve ndërkombëtar të trenave.

#### 4.4.1.5 Zëvendësimi i itinerarëve të trenave

Nëse vetë aplikantët, në kërkesën për alokimin e itinerarit të trenit, kërkojnë zëvendësimin e një itinerari treni që ju përshtatet atyre dhe nëse ka kërkesa për të njëtin itinerar treni nga më shumë se një aplikant, administruesi i IH do ta konsideroj këtë zëvendësim gjatë përgatitjes së draftit të orarit, në rastin kur një aplikant tjetër, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Shtojcën 2, do të fitoj të drejtën e përparësisë për alokimin e itinerarit të kërkuar të trenit. Në këtë rast itinerari i zëvendësuar i trenit konsiderohet si itinerari i kërkuar i trenit dhe është pjesë e draftit të orarit, nëse aplikanti ka të drejtën e përparësisë mbi aplikantët e tjerë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Shtojcën 2.

Për aplikantët pa të drejtat e përparësisë për alokimin e itinerarit të kërkuar të trenit sipas kritereve të përcaktuara në Shtojcën 2 ose me të drejtë të njëjtë, administruesi i IH në draftin e orarin do të konsiderojë një zëvendësim të mundshëm të itinerarit të trenit ose zgjidhje të tjera të mundshme. Nëse itinerari kombëtar i kërkuar i trenit përputhet me një grup itinerari ndërkombëtar treni, administruesi i IH rregullon një itinerar treni zëvendësues për itinerarin kombëtar të trenit në draftin e orarit.

#### 4.4.1.6 Proçedura e Konsultimit

AIH menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pune pas përgatitjes së dokumentit, e dërgon me shkrim ose me e-mail draftin e orarit për shqyrtim dhe vërejtje nga ana e aplikantëve ose paleve te interesuara per kapacitetin infrastrukturor. Aplikantët apo palet e interesuar duhet, brenda një muaji nga marrja e draftit të orarit, të paraqesin pikpamjet apo komentet e tyre me shkrim, me anë të e-mail-it ose faksit pranë AIH. Komentet e marra nga AIH pas kësaj periudhe nuk do të merren në konsideratë.

Nëse aplikanti nuk paraqet asnjë koment brenda afatit kohor të proçedurës së konsultimit, konsiderohet që ai i përmbahet kërkesës së tij origjinale.

#### 4.4.1.7 Ndryshimet në kërkesat për alokimin e itinerarëve të trenave

Ndryshimet në kërkesat për alokimin e itinerarëve të trenave që vijnë si rezultat i proçedurës së mesiperme te konsultimit llogariten si kërkesa të plota të paraqitura në kohë sipas proçedurës së alokimit të itinerarëve të trenave. Aplikantët duhet t’ja paraqesin administruesit te IH kërkesat e tyre të rishikuara për alokimin e itinerarëve të trenave me shkrim ose me e-mail brenda shtatë ditëve pas periudhës së marrjes së komenteve.

### 4.4.2 Proçedura e bashkerendimit, faktorët shtesë

Kur, pas proçedurës së konsultimit, mbi bazën e opinioneve apo komenteve të marra dhe duke përdorur kriteret e përcaktuara në Shtojcën 2 të këtij dokumenti, ekzistojnë akoma konflikte

midis aplikantëve individual ose kërkesave të palëve të tjera, ndërmerret proçedura e bashkerendimit me shkrim me kerkuesit e kapaciteteve i cili bazohet ne dhenien nga administruesi i IH e informacionit falas brenda 10 ( dhjete) diteve me shkrim ose ne forme elektronike (e-mail) si me poshte:
a) itineraret e trenave, të kërkuara nga të gjithë kërkuesit e tjerë të kapacitetit mbi të njëjtat linja;
b) itineraret e trenave, të caktuara paraprakisht për të gjithë kërkuesit e tjerë të kapacitetit mbi të njëjtat linja;
c) itineraret alternative të trenave, të propozuara për linjat në fjalë,
Ne informacionin e derguar nga administruesi i IH nuk do te zbulohet identiteti i kerkuesve te tjere te kapacitetit, perveçse kur kerkuesit ne fjale te kapacitetit kane rene dakort qe te jepet identifikimi i tyre.
Nepermjet kesaj proçedure AIH rregullon kërkesat konfliktuale. Aplikanti duhet ti dorëzojë AIH brenda 5 ditësh pas marrjes së informacionit, me anë të e-mail-it ose me shkrim qëndrimin e tij mbi zgjidhjet e propozuara, përndryshe konsiderohet që aplikanti ka rënë dakort me zgjidhjet alternative te propozuara nga AIH. Nëse, pas marrjes së qëndrimeve të aplikantëve, administruesi i IH dështon në zgjidhjen e kërkesave konfliktuale per ndarjen e kapaciteteve te infrastruktures, atehere do te vihen ne veprim per zgjidhjen e konflikteve kriteret e percaktuara ne shtojcen 2 te ketij dokumenti. Per venien e kesaj zgjidhje ne zbatim, merret nga administruesi i IH vendimi brenda afatit kohor 10 (dhjete) dite pune.

Nëse edhe pas kesaj proçedure bashkerendimi ka kërkesa te pa kenaqura per kapacitete infrastrukturore edhe pas keshillimit me kerkuesit e kapaciteteve, atehere administruesi i IH duhet te deklaroje per ate seksion infrastrukture te mbingarkuar ose e tejngopur.

### 4.4.3 Infrastruktura me kapacitet të mbingarkuar ose tejngopur.

Nëse administruesi i IH pas kryerjes se proçedurave te mesiperme percaktuar ne piken 4.4.2, nuk mundet të përmbush të gjitha kërkesat për kapacitetit infrastrukture, ai seksion i IH ku shfaqet konflikti duhet të deklarohet si infrastrukturë me kapacitet të mbingarkuar.
Ne rast se per tarifat e perdorimit te IH nuk eshte arritur nje rezultat i kenaqshem ne vjeljen e tyre dhe infrastruktura eshte deklaruar e mbingarkuar (tejngopur), administruesi i infrastruktures vendos kritere prioritare per ndarjen e kapaciteteve infrastrukturore.
Kriteret prioritare marrin parasysh rendesine e nje sherbimi ndaj publikut ne lidhje me çdo sherbim tjeter qe per pasoje perjashtohet, dhëne si me poshte:

- Rëndësia e shërbimit të transportit kombetar për udhetare, kundrejt sherbimit rajonal per udhetare,ose sherbimit transportit mallrave.
- Rëndësia e shërbimit të transportit nderkombetar të mallrave, ose sherbimit transportit mallrave brenda vendit.
- Rendesia e sherbimit te transportit te mallrave te rrezikshme kundrejt sherbimit transportit normal te mallrave.

Referuar kritereve prioritare administruesi i infrastruktures vendos per ndarjen e kapaciteteve infrastruktures.

### 4.4.4 Vendimi mbi alokimin e itinerarit të trenit

Administruesi i IH do të vendose për alokimin e itinerarit të trenave nëpërmjet një urdhri me shkrim **jo më vonë se dy muaj** para hyrjes në fuqi të orarit të ri. Bazuar në urdhrin me shkrim, aplikantit i dorëzohet kërkesa e plotësuar në mënyrën e duhur dhe alokimi i itinerarit të trenit.

Në kohën e duhur dhe kërkesat e plotësuara për alokimin e itinerarit të trenit mund të refuzohen, kur gjatë proçedurës së alokimit zbulohet se disa itinerare trenash nuk janë të mundur, ose kur e drejta për itinerarin në fjalë gjatë proçedurës së alokimit i është dhënë një aplikanti tjetër duke marrë në konsideratë faktorët e tjerë të përcaktuar në Shtojcën 2.

Aplikantët mund të paraqesin ankimimet e tyre për urdhrin me shkrim të lëshuar nga administruesi i IH lidhur me alokimin e itinerarit të trenit në mënyrën dhe kohën e duhur siç përcaktohen në pikën 4.4.8.
Ankimimi nuk është i vlefshem vetëm kur administruesi i IH dhe aplikanti, gjatë proçedurës së alokimit të itinerarit kanë ndjekur proçedurën e bashkerendimit dhe keshillimit, si dhe bashkarisht kanë rënë dakort për një zgjidhje në lidhje me alokimin dhe kjo është pjesë integrale e urdhrit të lëshuar.

Paraqitja e ankimimit nuk e kufizon zbatimin e urdhrit te administruesit IH.

#### 4.4.4.1 Njohja e urdhrave me shkrim mbi alokimin e itinerarëve ndërkombëtar të lëshuar nga menaxherë të huaj infrastrukture

Administruesi IH e njeh një urdher të lëshuar nga menaxherë infrastrukture të huaj mbi alokimin e një itinerari ndërkombëtar, nëse:

- Aplikanti përmbush kushtet e përcaktuara në seksionin 2.2 dhe
- Urdhri është në përputhje me protokollet e konferencës ndërkombëtare të trenave në kuadër të FTE dhe RNE.

Aplikanti që zotëron një alokim itinerari ndërkombëtar nga një menaxher infrastrukture i huaj duhet të nënshkruajë një kontratë me administruesin e IH lidhur me hyrjen dhe perdorimin e IH siç përcaktohet në pikën 2.4.2 në mënyrë që të ketë mundësinë të përdor itinerarin e alokuar.

### 4.4.5 Pagimi i kostove të proçedurës në rast të mos alokimit të itinerarit të trenit

Aplikanti duhet të paguaje administruesin e IH kostot e proçedurës për alokimin e itinerarit të trenit, nëse administruesi IH nuk i ka alokuar itinerarin e kërkuar të trenit për arsyet e mëposhtme:

- Aplikanti me dëshirë të tij tërheq kërkesën për alokimin e itinerarit të trenit,
- Nëse gjendet gjatë kryerjes së proçedurës që aplikanti nuk përmbush kushtet e përcaktuara për alokimin e itinerarit të trenit.

Në rastin e mos alokimit të itinerarit të trenit aplikanti duhet ti paguaj IH kostot e proçedurës per alokimin e itinerarit te trenit.

### 4.4.6 Orari i ri dhe zbatimi i tij

Administruesi i IH, mbi bazën e urdhrave të lëshuar në lidhje me alokimin e itinerarëve të trenave, harton orarin e ri dhe e publikon atë të paktën 15 ditë para fillimit të zbatimit të tij.

Kundrejt pagesës për koston e proçedures administrative, administruesi i IH i dërgon kompanisë hekurudhore nëpërmjet kontratës së firmosur lidhur me hyrjen dhe përdorimin e IH, dokumentacionin e nevojshëm dhe të kërkuar mbi orarin e ri të paktën 15 ditë para hyrjes në fuqi të tij. Orari i ri është i vlefshëm duke filluar nga data 10 Dhjetor 2025.

### 4.4.7 Zgjidhja e ankimimit lidhur me alokimin e itinerarit të trenit

Aplikanti që ka paraqitur pranë administruesit IHP një kërkesë të plotë për alokim në kohën e duhur, mund në rastin e një pakënaqësie lidhur me proçedurën e alokimit të itinerarit të trenit ose lidhur me informacionin dhe kushtet e publikuara në Deklaratën e Rrjetit, osë në raste të tjera që kanë të bëjnë me proçedurën e alokimit të itinerarit të trenit, të filloj proçedurën për zgjidhje e ankimimit.

Proçedura për zgjidhje e ankimimit, për ankesa në lidhje me proçedurën e alokimit të trenit është përcaktuar në Shtojcën 2 të këtij dokumenti.

### 4.4.8 Proçedura e Ankimimeve

Autoriteti Rregullator Hekurudhor (aktualisht mbulohet nga ministria pergjegjese per Infrastrukturen dhe Energjine) ka të drejtën e marrjes së vendimit lidhur me ankimimet e aplikuesve kundrejt urdhrave të lëshuar nga administruesi i IH, ose e nje operatori impianti sherbimi.
Aplikanti ka te drejte te ankohet nese beson se eshte trajtuar padrejtesisht, eshte diskriminuar ose ne ndonje menyre eshte demtuar, ne lidhje me:
a) deklaratën e rrjetit në versionet paraprake të përkohshme dhe përfundimtare;
b) kriterete përcaktuara në “Deklaratën e rrjetit”;
c) procesin e ndarjes së kapacitetit dhe rezultatin e këtij procesi;
ç) skemën e tarifimit;
d) skemën e përbërësve të tarifës që del detyrim për t’u paguar;
dh) marrëveshjet për qasje në infrastrukturë, në përputhje me nenet 10 deri në 13 të Kodit Hekurudhor nr 142/2016;
e) qasjen në rrjet dhe tarifimin për shërbimet, në përputhje me nenin 13 të Kodit Hekurudhor nr 142/2016.
Autoriteti Rregullator Hekurudhor (aktualisht ministria pergjegjese Infrastrukturen dhe Energjine) kerkon informacion nga administruesi infrastruktures, nga aplikuesit dhe çdo pale e trete e perfshire ne transportin hekurudhor. Informacioni i kerkuar dergohet brenda periudhes nje mujore prane Autoritetit Rregullator Hekurudhor.
Autoriteti Rregullator Hekurudhor (aktualisht ministria pergjegjese per Infrastrukturen dhe Energjine) duhet të jape vendimin e tij te arsyetuar brenda gjashte javeve nga data e marrjes së gjithe informacionit perkates kerkuar prej tij.
Vendimet e marra nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor i nenshtrohen shqyrtimit gjyqesor.

## 4.5 ALOKIMI I ITINERARIT TË TRENIT PËR MIRËMBAJTJE TË IH

Proçesi i alokimit të itinerarit të trenave i përshkruar në seksionet 4.2 dhe 4.4 përdoret edhe në rastet e alokimit të itinerarit të trenit për punimet e mirembajtjes se infrastrukturës hekurudhore publike.
1. Kërkesat për kapacitetet e infrastrukturës, që mundësojnë punimet që kryhen për mirëmbajtje, paraqiten gjatë procesit të përgatitjes së planifikimit kapaciteteve.
2. Administruesi i infrastrukturës merr parasysh ndikimin e rezervimit të kapaciteteve të infrastrukturës për punimet e mirëmbajtjes mbi kërkuesit e kapacitetit.
3. Administruesi i infrastrukturës informon palët e interesuara për pavlefshmërinë e kapacitetit të infrastrukturës, për shkak të punimeve të mirëmbajtjes së paplanifikuar.

## 4.6 MOS SHFRYTËZIMI I ITINERARËVE TË TRENAVE

Administruesi i IHA informon mbi shfrytëzimin dhe kapacitetetet e alokuar të trenave.
Nëse një aplikant nuk e përdor ose shfrytëzon kapacitetin infrastrukturor që i është alokuar nga administruesi i IH, atëherë administruesi i IH ka të drejtë t’ia rialokojë këto kapacitete një aplikanti tjetër.

Nëse një aplikanti që i është alokuar një kapacitet infrastrukturor që nënkupton një itinerar treni, dështon në shfrytëzimin e kapacitetit të alokuar mbi 50% për tre muajt në vijim, aplikanti mund t’ia jap këtë itinerar treni administruesit IH për periudhën që ka mbetur. Megjithatë kjo nuk është e vlefshme, në rastin kur mos shfrytëzimi i kapacitetit vjen si rezultat i shkaqeve jo-ekonomike që shkojnë përtej kontrollit të aplikantit.

Megjithese kapacitet e pashfrytëzuara jepen për shfrytëzim nje aplikanti tjeter, kurse aplikanti fillestar (zoteruesi i itinerarit të trenit) nuk gëzon të drejtën e përfitimit të ndonjë lloj rimbursimi nga administruesi i IH.

Perpara se administruesi i IH t’a japë në shfrytëzim kapacitetet e papërdorura aplikantëve të tjerë, duhet të informohet zoteruesi fillestar me anë të një njoftimi me shkrim që itinerari i tij i trenit do ti hiqet, dhe i jap atij mundësinë që te shpjegojë arsyet e nivelit të ulët të shfrytëzimit kapacitetit. Aplikanti ( zoteruesi fillestar i kapacitetit) do të marr një njoftim tjeter me shkrim nga administruesi i IH mbi vendimin e rialokimit te itinerarit trenit aplikantëve të tjere.

# 5 SHËRBIMET

## 5.1 KUADRI LIGJOR

Baza ligjore për përcaktimin e shërbimeve të Infrastrukturës Hekurudhore është përcaktuar në Nenet 15, 108 dhe 110 te Kodit Hekurudhor i Republikes Shqiperise nr 142/2016, që përcakton infrastukturën hekurudhore dhe përbërësit e tij, si dhe rekomandimeve Neni 13 pikat 1 dhe 2 e Direktives Nr 34/2012 e Bashkimit Europian shtojca e dyte e saj, dhe Metodologjia e Tarifes se Infrastrukturës Hekurudhore percaktuar ne kontraten koncesionare.

## 5.2 SHËRBIMET BAZË

Shërbimet bazë te paketes minimale:

- Shqyrtimi i kërkesave për itinerarët e trenave,
- Përdorimi i infrastruktures hekurudhës në itinerarët e alokuar,
- Përdorimi i ndërruesve dhe kalimeve ne nivel në itinerarët e alokuar të trenave,
- Kontrolli i trenave, së bashku me sinjalistikën, rregullimin, shpërndarjen dhe komunikimin e trenave, si dhe sigurimi i informacionin mbi lëvizjen e trenave,
- Informacion tjetër që nevojitet për përmbushjen dhe kryerjen e shërbimeve për të cilët është alokuar itinerari i trenave.

## 5.3 SHËRBIME TE TJERA

1. Lejimi, duke perfshire lejimin ne binare, per ne impiantet e sherbimeve ndihmese kur ata ekzistojne dhe per sherbimet e ofruar ne impiantet ndihmese:

a. stacionet e pasagjereve, ndertesat e tyre edhe impiante te tjera, duke perfshire tabelat e shfaqjes se informacioneve dhe vendndodhjet e pershtatshme per sherbimet e biletave

b. stacionet dhe terminalet e mallrave

c. linjat per rreshtim dhe impiantet e formimit te trenave duke perfshire impiantet per manovrime

d. binaret rezerve per qendrime te trenave

e. impiantet per mirembajtjen, me perjashtimin e impianteve te mirembajtjes dedikuar trenave te shpejtesise se larte ose llojeve te tjere te mjeteve levizes qe kerkojne impiante te posaçme

f. impiante te tjera teknike duke perfshire impiante per pastrime dhe larje,

g. impiantet shtese

Lejohet përdorimi i objekteve dhe pajisjeve me anë të një kërkese te vecante. Kompania hekurudhore duhet të sigurojë shërbimet e sipërpërmenduara me anë të një kontrate te veçante të firmosur midis administruesit të IH kur sherbimet ofrohen prej tij apo operatori i ofrimit te shërbimeve te ketyre impianteve.

## 5.4 SHËRBIME SHTESE

Shoqeria Albrail mund te ofroje sherbime shtese, ne varesi te kerkesave te klienteve si dhe dinamikes se tregut.

Kompania hekurudhore do ti sigurojë shërbimet shtese me anë të një kontrate te veçante të firmosur midis paleve.

## 5.5 SHËRBIMET NDIHMESE

Sherbimet ndihmese perfshijne:

a. lejimin ne rrjetet e telekomunikacionit
b. sigurimin e informacioneve shtese
c. inspektimin teknik te mjeteve levizes
d. sherbimet e biletimit ne stacionet e pasagjereve
e. sherbimet e mirembajtjes jo te mire/te pamjaftueshme ne impiantet e mirembjatjes te mjeteve levizes qe kerkojne sherbime specifike.

Kompania hekurudhore që i është alokuar një itinerar treni mund të kërkoj një grup tjeter shërbimesh përveç atyre të përfshira në shërbimet shtesë dhe të tjera, por administruesi nuk është i detyruar t’jua ofrojë, siç mund të jenë:

- Lidhje me rrjetin e telekomunikacionit, ( Jo i Aplikueshem administratori i IHP )
- Sigurimi i informacionit shtesë,
- Kontrolli teknik i mjeteve lëvizëse; ( Jo i Aplikueshem administratori i IHP )

Ofrimi i ketyre sherbimeve behet nepermjet një kontratë te vecante të lidhur midis administruesit të IH ose ofruesve të shërbimeve të tjera dhe kompanive hekurudhore, të bazuar në parimet e tregut.

# 6 TARIFAT

## 6.1 BAZA LIGJORE

Baza ligjore për përcaktimin e tarifave te shfrytëzimit Infrastrukturës Hekurudhore gjendet në nenet 30, 31 dhe 32 të Kodit Hekurudhor te Republikes Shqiperise nr 142/2016, që përcakton parimet apo kriteret mbi të cilat vendoset tarifa e shfrytëzimit infrastruktures hekurudhore, si dhe Shtojca 3 e kontrates koncesionare.

## 6.2 METODOLOGJIA E PERLLOGARITJES SË TARIFAVE TE PERDORUESEVE TE TRETE TE HEKURUDHES

### 6.2.1 Shërbimet që përbëjnë tarifën

**Shoqeria Koncensionare ka te drejte te vendose Tarifat e Transportuesve te Tjere te Hekurudhes gjate Periudhes se Koncensionitsipas metodologjise te percaktuar ne Shtojcen 3 te Kontrates Koncesionare (Metoda e Perllogaritjes se Tarifes se Shfrytezimit te Infrastruktures Hekurudhore).**
Bazën e tarifës së perdorimit e përbëjnë kostot e shërbimeve bazë siç përcaktohen në seksionin 5.2 të këtij dokumenti.

### 6.2.2 Parimet e tarifimit

Sistemi i tarifës së shfrytëzimit bazohet në parimet e mëposhtme:
- thjeshtësi në llogaritje,
- qartësi,
- e drejtë dhe transparence
- kosto e varesise

### 6.2.3 Formula e llogaritjes së tarifave të perdorimit

$$T =\{ (N_k * P_k) +( N_r * P_r) \}* C_{mall} * K * F$$

| | |
|---|---|
| T | tarifa shfrytëzimit për itinerarin e shpërndarë të trenit |
| $N_k$ | numri i tren km të përshkruar në linjat kryesore hekurudhore |
| $P_k$ | koeficenti i rendesise per vijat kryesore hekurudhore |
| $N_r$ | numri i tren km te pershkuar linjat rajonale hekurudhore |
| $P_r$ | koefiçienti i rendesise për vijen rajonale hekurudhore |
| $C_{mall}$ | çmim njesi baze ne njesi monetare për tren/km per trenat e mallrave |
| K | koefiçienti i amortizimit të shinave |
| F | koeficent, që shpreh kërkesat e transportuesve në lidhje me orarin |

Tarifa e perdorimit përcaktohet për çdo itinerar treni.

### 6.2.4 Vlerat e elementëve të veçantë të formulës për llogaritjen e tarifës perdorimit

#### 6.2.4.1 Koefiçienti i rendesise vijes hekurudhore P :

| | |
|---|---|
| - Vijat kryesore hekurudhore | **1,35** |
| - Vijat hekurudhore rajonale | **1,00** |

#### 6.2.4.2 Koefiçientët e amortizimit të shinave – K

| | |
|---|---|
| - Trenat e mallrave (mbi 2000 ton bruto) | **1,50** |
| - Trenat e mallrave (1000 ton bruto deri 2000 tone bruto) | **1,20** |
| - Trenat e mallrave (700 ton bruto deri 1000 tone bruto) | **1,00** |
| - Trena (500 ton bruto deri 700 tone bruto) | **0,80** |
| - Trena (200 tone bruto deri ne 500 tone bruto) | **0,50** |
| - Trenat me pak se 200 ton bruto | **0,35** |

#### 6.2.4.3 Faktori për kërkesën e Transportuesit Hekurudhore ne lidhje me orarin – F

| | |
|---|---|
| -Itinerarët e shperndare te trenave, te kerkuar para hyrjes ne fuqi te orarit | **1** |
| -Itinerarët e shperndare te trenave mbi bazen e kerkesave ad hoc | **1,2** |

## 6.3 ÇMIMET

### 6.3.1 Çmimi për tren kilometër

Çmimi për tren kilometër ( $C_{vlkm}$ ) është 10.3 euro/trenkm, pa përfshirë TVSH, per kushtet: qe pesha bruto e trenit te jete 1000 ton dhe per shpejtesi levizje 35 km/ore.

Gjithashtu, eshte e percaktuar qe koeficentet “K” dhe “P” te formules llogaritese te tarifes perdorimit, do te llogariten ne raport te drejte me peshen bruto faktike per çdo tren dhe shpejtesine e levizjes mesatare qe percaktohet ne grafikun e levizjes trenave nga Administruesi i Infrastruktures Hekurudhore per distancen ( itinerarin ) ne te cilen leviz treni.

### 6.3.2 Çmimi i shërbimeve shtesë

Një listë me shërbimet shtesë është publikuar në Shtojcën 3 të Deklaratës së Rrjetit.
Çmimi : Te pa miratuara deri tani.

### 6.3.3 Çmimi i shërbimeve të tjera

Një listë me shërbimet e tjera është publikuar në Shtojcën 3 të Deklaratës së Rrjetit.
Çmimi : Te pa miratuara deri tani.

### 6.3.4 Shpenzime të jashtme

Shpenzimet e jashtme momentalisht nuk përfshihen në tarifë.

## 6.4 PARIMET BAZË TË TARIFIMIT

Sistemi i tarifës së shfrytëzimit bazohet në parimet e mëposhtme:

- thjeshtësi në llogaritje,
- qartësi,
- e drejtë dhe transparence
- kosto e varesise
- jo diskriminuese.

## 6.5 PËRJASHTIME NGA TARIFA E PERDORIMIT

Përdoruesit që mirëmbajnë dhe modernizojnë IHA, menaxherët e trafikut hekurudhor dhe te transportit ne IH janë të përjashtuar nga tarifat e perdorimit.

## 6.6 NDRYSHIMET E TARIFAVE

Shoqeria Koncensionare ka te drejten te propozoje rishikimin e Tarifave te Transportueseve te Tjere te Hekurudhes cdo 4 (kater) vjet gjate periudhes se Koncensionit. Shoqeria Koncensionare pergatit nje propozim per ndryshime ne cdo rishikim periodik. Cdo propozim shoqerohet me dokumentacion me shkrim te supozimeve te perdorura dhe llogaritjeve te bera gjate pergatitjes se tij dhe miratohet nga Autoriteti Kontraktor.

## 6.7 REVOKIMI DHE ANULLIMI I ITINERARIT TË TRENAVE

**Revokimi i itinerarit të trenit** është heqja përfundimtare e itinerarit të trenit prej zoteruesit për të gjithë periudhën e orarit. Duke revokuar itinerarin e trenit kompania hekurudhore do të humbase të drejtën e përdorimit të këtij itinerari përgjatë gjithë periudhës së orarit të miratuar.

**Anullimi i itinerarit të trenit** do të thotë anullimi i një itinerari treni në një ditë ose ditë te veçanta nga zoteruesi . Kompania hekurudhore ruan të drejtën të shfrytëzoj më tej itinerarin e trenit gjatë periudhës së orarit të miratuar.
Ne keto raste zbatohen kushtet e meposhtme:

| | Kushte | Pagesa e tarifës së shfrytëzimit |
|---|---|---|
| 1. | **Revokimi** deri në 60 ditë para udhëtimit të parë të planifikuar. | Nuk paguhet tarifa e shfrytëzimit |
| 2. | **Revokimi** më shumë se 30 ditë dhe më pak se 60 ditë para udhëtimit të parë të planifikuar<br>– Itinerari i trenit | 50 % tarifa e shfrytëzimit për çdo itinerar treni |
| 3. | **Revokimi** para 30 ditëve para udhëtimit të parë të planifikuar:<br>Itinerari trenit | 1 x tarifa shfrytëzimit për çdo itinerar treni |
| 4. | **Anullim** më shumë se 24 orë para udhëtimit të planifikuar:<br>– Itinerari trenit | 50 % tarifa e shfrytëzimit për çdo itinerar treni |
| 5. | **Anullim** më pak se 24 orë para udhëtimit të planifikuar:<br>itinerari trenit | 1 x tarifa shfrytëzimit për çdo itinerar treni |
| 6. | Itinerari trenit as **nuk revokohet ose anullohet:**<br>- Itinerari trenit | 2 x tarifa shfrytëzimit për çdo itinerar treni |

## 6.8 ZBRITJE TE TARIFES

Administruesi i IHA mundet te aplikoje zbritje ne tarife per çdo sherbim duke ruajtur gjithmone koston reale, e cila aplikohet mbi pjesen e fitimit te krijuar si rezultat i investimeve te teknollogjive te reja per zbarimin e kushteve teknike per nderveprim ne lidhje me komande kontrollin dhe sinjalizimin e nensistemeve.
Administruesi i infrastruktures mund te aplikoje skema te zbritjes se çmimit per perdoruesit e infrastruktures per te inkurajuar:

a) perdorimin e linjave te reja apo te atyre qe perdoren nen kapacitet;
b) uljen e kohes perdorimit te nje segmenti hekurudhor te caktuar.

Zbritjet e çmimit lidhen vetem me tarifat e vendosura per nje seksion te caktuar te infrastruktures. Skema te ngjashme te zbritjes do zbatohen per sherbime te ngjashme.

### 6.9 NDRYSHIMI I ITINERARIT TË TRENIT

Ndryshimi i itinerarit të trenit nënkupton ndryshimin e të dhënave bazë në itinerarin ekzistues në emër të kompanisë hekurudhore që çon në shmangie nga orari i miratuar i itinerarit të trenit dhe ka si pasojë krijimin e një itinerari të ri treni.

Tarifa e ndryshimit është xx leke ( e pa miratuar akoma) për çdo itinerar treni.

## 7. SHTOJCAT

**SHTOJCE 1**
**TE DHENAT E INFRASTRUKTURES HEKURUDHORE**

**SHTOJCE 2**
**FORMULARËT DHE PROÇEDURA PËR APLIKIM PËR ITINERAR DHE UDHEZIMI PER PLOTESIM**

**SHTOJCA 3**
**SHËRBIMET SHTESË**

## SHTOJCE 1

## TE DHENAT E INFRASTRUKTURES HEKURUDHORE

1. Të dhëna teknike mbi vijat dhe stacionet hekurudhore (materialet bashkangjitur)
2. Harta e përgjithshme e vijave hekurudhore (materialet bashkangjitur)
3. Planet skematike të vijave në stacione (materialet bashkangjitur)
4. Hapësira e lirë dhe përmasat e ngarkesës (materialet bashkangjitur)
5. Pasqyrë e përgjithshme e pjerrësive, rezistencave dhe shpejtësive në vijat hekurudhore (materialet bashkangjitur)
6. Lista e stacioneve që pranojnë transportin e mallrave
   - Stacioni i mallrave Fier
7. Vijat e pajisura me pajisje sinjalistike dhe sigurie (materialet bashkangjitur)

# SHTOJCE 2

# FORMULARËT DHE PROÇEDURA PËR APLIKIM PËR ITINERAR DHE UDHEZIMI PER PLOTESIM

## 2.1 Formulari i aplikimit për alokimin e itinerarit të trenave

Albrail
Fier
Tel ----
e-mail: info@albrail.al

**Formulari i aplikimit për alokimin e itinerarit të trenave**

Ndërmarrja hekurudhore_______________________________________________
Adresa__________________________________________________________
Personi kontaktues_________________________________________________
Tel__________________________fax_________________e-mail_______________

| 1. Shënimet bazë për porosi të trasesë së trenit | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Lloji i trenit | Nr. i trenave në orarin e kaluar | Koha e dëshiruar | Relacioni | |
| Nisja | arritja | prej | deri | via |
| Vërejtje: | | | | |

| 2. Shënimet në lidhje me OLT-ën | | |
|---|---|---|
| Ndalesat ne vende zyrtare | Koha e qëndrimit në vende zyrtare | Kalendari i lëvizjes |
| | | |
| | | |
| | | |

| 3. Shënimet për tren | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Lloji i tërheqjes, seria,relacioni | Lokomotiva plotësuese ,Seria relacioni | Lloji dhe numri i vagonëve /GM | Masa e trenit (t) | Gjatësia e trenit (m) | Frenimi (lloji) | Frenimi<br>Përqindja (%) | Shpejtësia maksimal e e trenit |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

| 4. Të dhëna të veçanta |
|---|
| |

## 2.2: Formulari për porosinë e trasesë së trenit

### Udhëzimi për plotësimin e formularit për porosinë e trasesë së trenit

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Lloji i trenit | Të ceket lloji i trenit:<br>Tren për transportin e udhëtarëve (tren ekspres, treni i shpejt , tren lokal ose garniturë e zbrazë)<br>Tren i mallrave (të gjitha llojet e mundura) |
| | Nr, i trenave në orarin e kaluar | Të ceket numri i trenave nga orari i kaluar për të cilët përputhen të gjitha elementet me porosinë ( psh nr 891 ose 55981) |
| | Koha e dëshiruar | Të cekët koha e dëshiruar e nisjes së trenit nga stacioni fillestar dhe koha e dëshiruar e arritjes në stacionin fundor. |
| | Relacioni | Të ceken stacioni i nisjes dhe fundor të trenit dhe stacionet karakteristike në mes të këtyre dy stacioneve. |
| 2 | Ndalja në vende zyrtare | Të ceken të gjitha vendet zyrtare në të cilat ka nevojë për ndalje të trenit. |
| | Koha e qëndrimit në vende zyrtare | Të ceket koha e qëndrimit të trenit veçmas për çdo vend zyrtar. |
| | Kalendari i lëvizjeve | Të ceken ditët kur kërkohet lëvizja e trenit |
| 3 | Lloji i tërheqjes, Seria, relacioni | Të cekët lloji i tërheqjes, Numri serik i lok, dhe relacioni i tërheqjes. |
| | Lokomotiva plotësuese | Të cekët llojin e lok. Plotësuese , numrin Serik, relacionin ( ndihmëse ose prapa shtues, e tje) |
| | Lloji dhe numri i vagonëve | Të ceken numri dhe lloji vagonëve (Shenjat, nr serik individual) ose Garniturës Motorike |
| | Masa e trenit | Të ceket masa e të gjitha mjeteve lëvizëse në përbërje të trenit |
| | Gjatësia e trenit në metra | |
| | Frenimi- lloji | |
| | Shpejtësia maksimale | |
| 4 | Të dhëna të veçanta | Të ceken shënimet e veçanta në lidhje me manovrimin, ndërrimin e përbërjes së trenave, lidhjet e trenave, ndërrimin e personelit, transportin e dërgesave me materie të rrezikshme , transportet ushtarake, procedurat e pranim dorëzimit në stacionet kufitare etj |

## 2.3 Proçedura dhe metoda e vlerësimit për kriteret e alokimit të itinerarit të trenit

Infrastruktura e mbingarkuar. Perkufizimi, procesi dhe kriteri i prioritetit

-

Nëse për arsye të mbingarkesës së kapaciteteve, IHA në procedurën e koordinimit nuk mund t’i përfshijë të gjitha kërkesat e operatorëve hekurudhor, IHA do të kërkoje që kapacitetet hekurudhore t’i deklaroje si të “mbingarkuara” dhe për këtë ta informoje Autoritetin Rregullator Hekurudhor. Në rastet kur IHA e deklaron “mbingarkesën” e Infrastrukturës, e bën analizën e kapaciteteve në infrastrukturën e mbingarkuar dhe i percakton kufizimet për të cilat s’ka pasur mundësi që të plotësohen kërkesat për alokimi të kapaciteteve, atëherë ai duhet të propozoje planin për përmirësimin e kapaciteteve të caktuara.

Kapacitetet e Infrastrukturës nuk mund të kuptohen si të mbingarkuara në këto raste:

- nëse nevoja për kapacitetet e përmendura nuk kalon 9 muaj dhe nëse nuk parashikohet se kapacitetet e përmendura rishtazi do të kërkohen;
- kur kapacitetet e infrastrukturës nuk mund të alokohen për shkak të kryerjes së punëve në mirëmbajtje të infrastrukturës; dhe
- kur IHA me arsye dyshon që ndërmarrja hekurudhore nuk do ta shfrytëzoje trasenë e kërkuar.

Nëse numri i kërkesave për alokim të të njëjtit kapacitet të infrastrukturës tejkalon kapacitetin e lejuar të asaj traseje, IHA do t’i përdore rregullat e prioritetit sipas kësaj renditje:

1. shërbimet publike të transportit të udhëtarëve;
2. shërbimet e transportit të kombinuar;
3. shërbimet e transportit të mallrave nga komunikacioni ndërkombëtar; dhe
4. shërbimet tjera të transportit të mallrave.

Duke i marre parasysh prioritetet e mësiperme, alokimi i traseve do të bëhet sipas këtyre rregullave:

- kërkesat për trena të rregullt kanë përparësi para trenave të jashtëzakonshëm dhe të posaçëm;
- kërkesat për trase të trenave sipas kornizës së marrëveshjeve kanë përparësi nga kërkesat e reja;
- kërkesat për trase të trenave të cilët përfshihen për një periudhë të gjatë kohore, kanë përparësi nga kërkesat për periudha kohore të shkurta;
- kërkesat për trase të trenave në relacione të gjata, kanë përparësi nga trasetë e trenave në relacione të shkurta në të njëjtën rrugë udhëtim; dhe
- në rastet kur të gjitha kushtet e lartcekura janë të njëjta, do të shërbehet ai i cili i pari ka bërë kërkesën.

Nëse operatori hekurudhor mendon që i është trajtuar ne menyre te padrejtë, ai mund ta parashtroje ankesën pranë Autoritetit Rregullator Hekurudhor.

## 2.4 Proçedura për zgjidhjen e ankimimeve në kuadër të proçedurës për alokimin e itinerarit të trenit

Procedurat e zgjidhjes së ankimimeve për asetet e infrastrukturës fillojnë me paraqitjen e vërejtjeve të shkruara nga ana e Operatorit Hekurudhor lidhur me pranimin/mospranimin e plotë ose të pjesshëm të OLT-së. Ankesa së pari duhet t’i drejtohet IHA në adresën: “Lagje nr 2,

Rruga Faik Konica, Pallati AL & GI, Hyrja 1, Kati 4, Tirane” Albania, email: info@albrail.al, Nëse nuk mund të gjendet zgjidhje, atëherë aplikanti mund të bënë ankimin në Autoritetit Rregullator Hekurudhor (aktualisht Ministria e Infrastruktures dhe Energjise) ne adresen Rr. “Abdi Toptani”, Nr.1, 1001, Tiranë, Shqipëri, email: sekretaria@infrastruktura.gov.al

# SHTOJCA 3

## SHËRBIMET SHTESË

Shoqeria Albrail mund te ofroje sherbime shtese, ne varesi te kerkesave te klienteve si dhe dinamikes se tregut.

Kompania hekurudhore do ti sigurojë shërbimet shtese me anë të një kontrate te veçante të firmosur midis paleve.

**Administruesi i Infrastruktures Hekurudhore**

**Dritan Spahiu**
**Administrator i shoqerise Albrail shpk**